Ne promovuam partneritete në aspektin ndërkombëtar dhe në vend, dhe praktikat dhe rezultatet tona të mira u njohën nga partnerët tanë të sektorit të korporatave, organizatat partnere, nga Lëvizja dhe agjencitë ndërkombëtare, të cilat rezultuan në një mbështetje të konsiderueshme për aktivitete të ndryshme të projektit dhe aktivitete programuese për përmirësimin e jetës së kategorive të ndryshme të popullsisë së prekshme. Diseminimi dhe rivendosja e lidhjeve familjare gjithashtu kanë luajtur një rol të rëndësishëm në punën tonë për ndarjen e vlerave njerëzore dhe të drejtës ndërkombëtare humanitare dhe sigurimin e mbrojtjes humanitare. Ne gjithashtu kemi punuar në shpëtimin e ujit dhe malit, dhe në shumë aktivitete të tjera të përfshira në reportin vjetor të organizatës sonë, të cilin me kënaqësi të madhe do të donim ta ndajmë me ju.

Arritjet tona janë shtysë për më shumë punë. Sfidat tona janë motivimi ynë. Falënderime për të gjithë vullnetarët, partnerët dhe stafin tonë që kontribuan në arritjen e qëllimeve tona.

Dr. Sait Saiti
Sekretar i Përgjithshëm

Prof. Dr. Romel Velev
Kryetar

AKTIVITETET E ZHVILLIMIT TË SHOQATËS NACIONALE DHE BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR I PARTNERITETIT



Pas zvogëlimit të intensitetit të lëvizjes së migruesve dhe fatkeqësive natyrore që kanë ndodhur vitet e fundit, në vitin 2019 Shoqata Nacionale filloi të analizojë pozicionimin organizativ, efikasitetin e punonjësve të Zyrës Qendore, azhurnimin e informacionit dhe punës administrative duke përdorur zgjidhje softuerike, dhe përmirësimin e kornizës normative të Shoqatës Nacionale.

Takimet e Këshillit Udhëheqës dhe Kuvendit. Në vitin 2019, janë mbajtur njëmbëdhjetë mbledhje të Këshillit Udhëheqës dhe dy mbledhje të Kuvendit të KKRMV:

Ndryshimi i Ligjit të Kryqit të Kuq. Gjatë vitit nga ana e shtetit u miratua Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë. Me ndryshimet dhe plotësimet legjislativë janë rregulluar kompensimet që në bazë të Ligjit, personat juridikë dhe fizikë në vend janë të obliguar për t'i paguar në favor të Kryqit të Kuq. Si rezultat i këtyre ndryshimeve legjislativë, u prezantua një sistem i brendshëm për shpërndarjen e fondeve sipas Ligjit.

Vlerësimi i nevojave për zhvillimin organizativ. Në procesin e planifikimit të Programit Vjetor të vitit 2020 dhe Planit Strategjik 2030, Kryqi i Kuq zhilloi një analizë të nevojave organizative të zhvillimit në mënyrë që të ketë një qasje gjithëpërfshirëse dhe në mënyrë më efektive të identifikojë nevojat reale në të gjitha nivelet e organizatës. Në formë të shkruar përmes një pyetësori OKKK-të prezantuan sfidat e

tyre të tanishme operative, përparësitë për vitin e ardhshëm, format e monitorimit dhe vlerësimit, nevojën për mbështetje nga Zyra Qendore e KKRMV dhe punën e projektit.

Metodologjia për vlerësimin e punës së OKKK/KKQSH. Në nënitor të vitit 2019, u miratua një metodologji vlerësimi e bazuar në rezultatet e aktiviteteve të zbatuara të pjesëve integrale të Shoqatës Nacionale në trembëdhjetë fusha thelbësore. Me aplikimin e metodologjisë së re dhe kritereve për vlerësimin e OKKK/KKQSH, përpjekjet për të forcuar kapacitetin organizativ mund të drejtohen në mënyrë më efektive.

Fondi i zhvillimit dhe projekteve. Kryqi i Kuq futi një sistem të brendshëm për shpërndarjen e një pjese të fondeve të marra nga Ligji i Kryqit të Kuq dhe 50% e fondeve të siguruara nga pagesa vjetore e anëtarësimit të organizatave komunale të Kryqit të Kuq në fondin e zhvillimit dhe projekteve i cili ka për qëllim të mbështesë projekte të vogla zhvillimi të OKKK dhe KKQSH. Në vitin 2019 u miratua Rregullorja e Punës së Fondit, u emërua Këshilli Drejtues me mandat dyvjeçar, u përcaktuan formatet e projektit dhe buxhetit, dhe u shpall një thirrje për ndarjen e fondeve për 7 projekte të vogla deri në 150,000 denarë që do të përzgjidhen dhe zbatohen në fillim të vitit 2020.

Takimet koordinuese. Më 18.06.2019 dhe 30.10.2019, u mbajtën takime koordinuese me sekretarët e OKKK dhe KKQSH. U diskutuan ndryshimet legjislativë dhe rregulloret për shpenzimin e fondeve që rrjedhin nga Ligji i Kryqit të Kuq, monitorimi dhe vlerësimi, kriza e migruesve, sistemi informativ DocuShare, PSO për trajtimin e situatave të jashtëzakonshme dhe më shumë.

Bashkëpunimi i Kryqit të Kuq të RMV dhe Kryqit të Kuq Bullgar. Një punëtori për shkëmbimin e përvojave të shoqatave nationale u mbajt në Sofje nga 25 deri në 27 Prill. Përfundimet e takimit iu diseminuan bashkëpunëtorëve profesionalë të programit për planifikimin operativ të aktivitetave të përbashkëta. Një vizitë studimore në Sofje u mbajt në korrik për të shkëmbyer përvojat në aplikimin dhe menaxhimin e projekteve të mbështetur nga Bashkimi Evropian.

Takimi i liderëve të shoqatave nacionale. Në periudhën 4-6 qershor 2019, në Sofje, Bullgari, në kuadër të Rrjetit “Fqinjët ndihmojnë të parët” u zhvillua takimi i 2-të i liderëve të Shoqatave Nacionale të Evropës Juglindore. U diskutua normimi (standardizimi) dhe themelimi formal i iniciativës së rënë dakord më parë për bashkëpunim dhe mbështetje në rast të situatave urgjente dhe katastrofave, të rrjetit të krijuar rajonal dhe koordinimit operativ të punës së rrjetit.

Takimet statutore të Lëvizjes. Në periudhën 4-12.12.2019 në Gjenevë, Zvicër, u mbajtën takimet statutore të Lëvizjes, Kuvendi i Përgjithshëm i Federatës Ndërkombëtare (4-7.12.2019), Këshilli i Delegatëve (08.12.2019) dhe Konferanca Ndërkombëtare (9-12.12.2019). Në takimet u miratuan një strategji e re e Federatës Ndërkombëtare 2030, plani dhe buxheti për dy vitet e ardhshme, njohja zyrtare të ShN të KK të Butanit dhe Ishujve Mareshal, si dhe akte të tjera në kuadër të FNKK. Në konferencë u miratuan disa rezoluta me interes për punën e Lëvizjes.

Vizita të shoqatave partnere nacionale, KNKK-së dhe FNKK-së. Gjatë vitit u mbajtën disa takime me shoqatat partnere nacionale për mbështetje, bashkëpunim dhe shkëmbim të ndërsjellë të përvojave. Kryqi i Kuq i RMV u vizitua nga delegacionet e Kryqit të Kuq nga Italia, Zvicra, Norvegjia, Austria, Bullgaria, Kro-

acia, Serbia, Mali i Zi, B e H, Kosova dhe Gjysmëhëna Turke. KNKK dhe FNKK kryen vizita për të monitoruar mbështetjen e aktivitetave të zbatuara me ta. Një pjesë e delegacioneve kanë bërë vizita në organizatat partnere dhe institucionet shtetërore të përfshira drejtpërdrejt në implementimin e projekteve që ata i mbështesin.

Nismë projekti me Kryqin e Kuq Austriak. Në periudhën nga 27 deri më 30 Nëntor të vitit 2019, Kryqi i Kuq u vizitua nga z. Eduard Trampush, Shefi i Repartit të Operacioneve Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq të Austrisë. Qëllimi i vizitës ishte rishikimi i mundësisë së sigurimit të mbështetjes së projektit dhe mbështetjes konsultative për rigjallërimin e Qendrës së Kryqit të Kuq të RMV në Dojran, gjegjësisht shndërrimin e saj në një Qendër të Mbështetjes së të moshuarve, duke ofruar shërbime të ndryshme institucionale për të moshuarit.

Plani Strategjik i Kryqit të Kuq të RMV 2020-2030. Në vitin 2019 filloj procesi i përgatitjes së planit të ri të zhvillimit të organizatës për dhjetë vitet e ardhshme, në përputhje me kornizën dhe udhëzimet e dhëna nga Federata Ndërkombëtare e Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënes së Kuqe. Plani strategjik do të jetë një bazë e kornizës për drejtimin në të cilin organizata do të lëvizë në dekadën e ardhshme. Dokumenti përmban qëllimet strategjike, aktivitetet dhe transformimet e parashikuara që organizata do të duhet të kalojë në periudhën e ardhshme për të përbushur sfidat e ardhshme



MENAXHIMI I VULLNETARËVE DHE ANËTARËSISË

Anëtarësia e Kryqit të Kuq të RMV. Motivimi i njerëzve për të qenë anëtarë të Organizatës së Kryqit të Kuq është që të jepin mbështetje financiare me pagësën vjetore të anëtarësimit dhe të jenë pjesë e procesit demokratik të udhëheqjes së organizatës duke pasur të drejtën për të votuar dhe për t'u zgjedhur dhe për të kontribuuar në politikën dhe udhëheqjen në nivelin lokal dhe nacional. Një numër i madh i anëtarëve të organizatës janë edhe vullnetarë të cilët herë pas here ose rregullisht kryejnë aktivitete vullnetare të cilat përmirësojnë kapacitetin e organizatës për të siguruar një numër të mjaftueshëm të ekspertëve për ofrimin e shërbimeve cilësore. Për të vendosur kornizën minimale për sigurimin e numrit të kërkuar të anëtarëve në fillim të vitit 2018, u miratua një Rregullore për metodologjinë e përcaktimit të numrit minimal të anëtarëve në OKKK. Të dhënat nga organizatat komunale të Kryqit të Kuq në lidhje me numrin e anëtarëve në vitin 2019 tregojnë se sigurimi i anëtarësisë në nivelin lokal është ende një sfidë dhe aktivitetet vazhdojnë të planifikohen dhe avancohen vazhdimisht.

Në këtë periudhë shumë persona kyçen në aktivitetet e Kryqit të Kuq si vullnetarë, ndërsa një pjesë e tyre bëhen edhe anëtarë të organizatës.

Numri i sesioneve të mbajtura orientuese: 288

Numri total i pjesëmarrësve të sesioneve orientuese: 3.200

Numri i vullnetarëve të bashkuar si rezultat i sesioneve të mbajtura orientuese: 1.050

Numri i anëtarëve të bashkuar si rezultat i sesioneve të mbajtura: 1.035

Orientuesit e Kryqit të Kuq të RMV. Në vitin 2018, Shoqata Nacionale ka filluar një iniciativë për të sjellë orientues në Kryqin e Kuq të cilët do të kenë për detyrë promovimin e vullnetarizmit të Kryqit të Kuq në nivelin lokal dhe animimin e anëtarëve dhe vullnetarëve të rinj duke mbajtur sesione orientuese për personat që janë të interesuar të përfshihen në punën e Kryqit të Kuq. Shoqata Nacionale ka përgatitur një doracak dedikuar për trajnim dhe ka kryer trajnimin për orientues nga çdo organizatë komunale e Kryqit të Kuq të RMV. Pas kryerjes së trajnimit, në secilën prej organizatave komunale të Kryqit të Kuq mbahen sesione orientuese me vullnetarë, në mënyrë që t'u sigurohet atyre trajnim bazë mbi qëllimet dhe detyrat e Organizatës dhe detyrat

Pasqyrë e anëtarëve të Kryqit të Kuq të RMV në vitin 2019

OKKK	Numri i anëtarëve	OKKK	Numri i anëtarëve	OKKK	Numri i anëtarëve	OKKK	Numri i anëtarëve
Berovë	245	Dibër	295	Negotinë	280	Strumicë	647
Manastir	630	Dellçevë	280	Ohër	446	Tetovë	2330
Vallandovë	255	Kavadar	466	Prilep	686	Shtip	402
Veles	440	Kërçovë	448	Probishtip	243	Qendër	777
Vinicë	470	Koçanë	367	Radowish	338	Gazi Babë	688
Gjevgjeli	320	Kriva Pallankë	282	Resnjë	243	Karpoš	759
Gostivar	686	Krushevë	200	Sveti Nikole	280	Kisella Vodë	768
Demir Hisar	200	Kumanovë	720	Strugë	441	Çair	720
GJITHSEJ							16.369

vullnetare për përfshirje të mundshme në aktivitetet e Kryqit të Kuq në nivelin lokal. Gjatë kësaj periudhe shumë persona po përfshihen në aktivitetet e Kryqit të Kuq si vullnetarë dhe disa prej tyre afrohen edhe si anëtarë të Organizatës.

Shënim i Ditës Botërore të Vullnetarizmit 5

Dhjetori. Kryqi i Kuq shënoi Ditën Botërore të Vullnetarizmit - 5 Dhjetorin, nën moton „Faleminderit vullnetarë“. Me këtë rast Kryqi i Kuq dha tri mirënjoje-falenderime për vullnetarë të shquar: Dr. Lulzim Jahoja - OKKK Kërçovë; Veleva Novka - OKKK Radowish; Dr. Vllado Haxhi Naumov - OKKK Veles. Ngjarja qendrore u mbajt më 5 Dhjetor në Hub-in Rinor, Zyra e Presidentit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në prani të vullnetarëve dhe punonjësve të Kryqit të Kuq të RMV, përfaqësues të institucioneve dhe mysafirë.



AKTIVITETET RINORE

Implementimi i aktivitetave humanitare të Organizatës së Kryqit të Kuq kryhet kryesisht përmes rrjetit të klubeve rinore të Shoqatës Nacionale ku vullnetarë deri në moshën 30 vjeç janë organizuar për të planifikuar, zbatuar dhe vlerësuar aktivitetet që i kryejnë ata. Klubet rinore janë gjithashtu një formë përmes së cilës të rindjtë zhvillojnë programe dhe politika në Kryqin e Kuq, marrin pjesë në proceset e vendimmarrjes në Organizatë dhe zhvillojnë kapacitetet e tyre, shkathtësitë sociale dhe fitojnë përvojë të caktuar profesionale.

Klubet Shkollorë të Kryqit të Kuq. Klubet në shkollat fillore dhe të mesme në koordinim me organizatën komunale kryejnë aktivitetet mbështetëse për grupe të ndryshme të synuara. Të rindjtë organizohen më afër shtëpive të tyre përmes një programi të unifikuar që është në përputhje me programin mësimor të shkollës për tërë vitin shkollor. Janë koordinuar nga një vullnetar përgjegjës i Kryqit të Kuq dhe një arsimtar i ngarkuar me detyrë nga shkolla.

**Në 31 klube rinore
të OKKK dhe KKQSH
aktivë janë 2208 vull-
netarë të rinj të Kryqit
të Kuq**



Procesi zgjedhor midis të rinjve në Shoqatën Nacionale. Në periudhën 30 Mars – 30 Qershor është kryer procesi i zgjedhjeve të liderëve të rinj të klubeve rinore në organizatat komunale të Kryqit të Kuq dhe Kryqit të Kuq të Qytetit të Shkupit, si dhe i kryetarit, nénkryetarit dhe trupit koordinues të të rinjve në nivelin nacional për periudhën e mandatin të viteve 2019-2021. Përbërja e re e zgjedhur e Trupit Koordinues përgatiti një plan të aktivitetave për tërë mandatin dhe gjatë vitit 2019 mbajti 4 takime të rregullta. Kryetar i të rinjve u zgjodh Dr. Alenka Shopova e Organizatës Komunale Qendër.

U mbajt Kampi Nacional Rinor “100% Kryqi i Kuq”, 29.06-05.07.2019, Velestovë, Ohër. Në periudhën nga 29 Qershori deri më 5 Korrik, në Velestovë, Ohër, u mbajt Kampi nacional i vullnetarëve të rinj të Organizatave Komunale të Kryqit të Kuq të RMV, ku morën pjesë gjithsej 65 pjesëmarrës. Kampi kishte për qëllim të trajnojë liderët e rinj të Klubeve Rinore si të udhëheqin vullnetarët në klubet e tyre dhe si të organizojnë dhe realizojnë aktivitete në komunitetin e tyre.

Edukatat rinore të bashkëmoshatarëve.

Qasja "moshatari për moshatarin" është pjesë integrale e shumë aktivitetave programore të Kryqit të Kuq të RMV. Edukimi i të rinjve dhe rritja e vetëdijesimit mbi preventivën e shëndetit dhe mirëqenies së tyre janë një nga aktivitetet bazë të klubeve rinore të Kryqit të Kuq. Duke aplikuar teknika kreative dhe metoda ndërvepruese, vullnetarë të trajnuar organizojnë punëtori dhe lloje të tjera aktivitetesh përmes së cilave përcjellin informacionin në mënyrën më të pranueshme tek grupe i synuar.

Gjatë vitit 2019 janë organizuar punëtoritë edukative në vijim:

Në vitin 2019 janë formuar 34 klube të reja shkollore kështu që numri total i klubeve shkolllore të Kryqit të Kuq është 101 klube në 25 OKKK.

Tema	Gjithsej numri i punëtorive	Gjithsej numri i pjesëmarrësve
Parandalimi i HIV/SIDA dhe ITS	178	295
Parandalimi i trafikimit të qenieve njerëzore	630	280
Parandalimi i sëmundjeve të varësisë	255	466
Ndihma e Parë	440	448
Diseminimi	470	367
Mbrojtja e shëndetit të dhëmbëve	87	282
Promovimi i higjenës	686	200
Punëtori të tjera të parandalimit	50	720

Akademia Rinore. Në periudhën 20-22.10.2020 në Strugë u mbajt Akademia Rinore e parë e Kryqit të Kuq. Akademia është një formë e aftësimit të certifikuar të kuadrove për zhvillimin dhe implementimin e programeve përfundimtare. Në këtë Akademi morën pjesë 17 përfaqësues të KKRMV të cilët patën mundësinë të përvetësojnë njohuri dhe shkathtësi për zhvillimin e trajimeve të vullnetarëve të rinj për edukimin e bashkëmoshatarëve lidhur me programet preventive të Kryqit të Kuq. Pas përfundimit të pjesës praktike, ata do të marrin titullin "Trajnues i edukimit të bashkëmoshatarëve i të rinjve për programet preventive të Kryqit të Kuq".

Në gjithsej 826 punëtori edukative janë përfshirë 20059 pjesëmarrës.

Në 30 OKKK janë organizuar gara komunale të ndihmës së parë ku kanë marrë pjesë 1482 nxënës të shkollave fillore dhe të mesme.

PUNA E PROJEKTIT

Gjatë vitit 2019 u hartua analiza e gjendjes së rrjedhës së punës së projektit dhe u përcaktuan prioritetet në këtë fushë. Kryqi i Kuq në mënyrë aktive ndoqi mundësitet e hapura të Fondeve të BE-së dhe mundësitet tjera të financimit dhe bashkëpunoi në mënyrë bilaterale me Kryqin e Kuq Austriak dhe Zvicran, duke realizuar disa projekte të përbashkëta. Në mesin e tyre ishte gjithashtu studimi i fizibilitetit përfutjen e një shërbimi të ri "Butoni i ndihmës urgjente përf të moshuarit në kushtet shtëpiake", i zbatuar me Kryqin e Kuq të Qytetit të Shkupit, dhe në bazë të rezultateve të marra u përgatit dhe iu dorëzua një projekt BE-së(EaSI) për implementimin e atij shërbimi në partneritet me MPPS. U përgatitën gjithashtu disa propozim-projekte me të cilat është marrë pjesë në thirrjet e hapura të BE-së përmes mbështetjen e de-institucionalizimin në vend përf personat e akomoduar në Entin Special Topansko Pole, në partneritet me Lidhjen e Defektologëve të RMV dhe Entin Special Topansko Pole. U përgatit gjithashtu një dokumentacion i projektit përf zhvillimin e ndërmarrësise sociale në bashkëpunim me WYG Kroaci dhe Izbor-Strumicë. Në bashkëpunim me KK të Republikës

së Bullgarisë u përgatit një dokumentacion i projektit për krijimin e një sistemi të ndihmës dhe mbështetjes psiko-sociale në kushtet katastrofash dhe ai është subjekt i financimit nga Ministria e Punëve të Jashtme të Bullgarisë.

U shfrytëzuan gjithashtu disa mundësi shtesë për grante të vogla, por puna e projektit mbetet një fushë e avancimit në nivel nacional, dhe për këtë arsy, në përputhje me ndryshimet e reja në sistematizimin e vendeve të punës së KKRMV, është hapur një pozicion i veçantë pune. Kryqi i Kuq në Korrik të vitit 2019 ishte nikoqir i Kryqit të Kuq Kroat dhe Bullgar me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe avancimit të bashkëpunimit në punën e projektit. U prezantuan përvojat e të tria shoqatave mbi instrumentet financiare para aderimit dhe fondet tjera të BE-së, duke iu referuar fondeve pér shtetet anëtare të BE-së.



MOBILIZIMI I FONDEVE NGA SEKTORI I KORPORATAVE

Një nga qëllimet zhvillimore të Kryqit të Kuq për mobilizimin e fondeve nga sektori i korporatave éshtë krijimi i një bashkëpunimi të partneritetit dhe mbështetja e kompanive. Kryqi i Kuq realizoi bashkëpunim me shumë kompani që praktikojnë punën e përgjegjshme shoqërore dhe në këtë mënyrë siguroi mbështetjen e projekteve dhe aktivitetave programore të ndihmës për grupet e prekshme të synuara. U realizua një bashkëpunim me odat ekonomike në vend që dhanë mbështetje në implementimin e aksioneve humanitare të Kryqit të Kuq. Më 16 dhjetor të vitit 2019 u mbajt Takimi i 10-të i Partneritetit të Kryqit të Kuq ku mori pjesë Ministrja e Punës dhe Politikës Sociale, z-ja Milla

Carovska, përfaqësues të institucioneve, sektorit të korporatave dhe Kryqit të Kuq. Në këtë takim u prezantua katalogu i përgatitur i projekteve të Kryqit të Kuq si nxitje e interesit të partnerëve për veprim të përbashkët dhe krijim të partneriteteve strategjike në sfera të caktuara të interesit të ndërsjellë. Në shenjë falënderimi për mbështetjen e ofruar nga partnerët për implementimin e projekteve shoqërore dhe aktiviteteve humanitare të Kryqit të Kuq, u dhanë mirënjojet e mëposhtme:

- Mirënjojhe të veçanta për Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale, Qytetin e Shkupit, Radio Televizionin e Maqedonisë, Kishën "Jezu Krishti dhe Shenjtorët e Ditëve të Mëvonshme" në Maqedoninë e Veriut**

- ## **Mirënjojja "Mbështetësi i Arg-jendtë" për Kompaninë OKTA SHA Shkup**

- Mirënjojha "Mbështetësi i Bronzët" për Fondacionin e Zhvillimit të Arsimit Albz.

PROGRAMET SOCIALE-HUMANITARE

Pushim dhe rekreacion për fëmijët e familjeve në rrezik social përfitues të shtesës së veçantë. Nga 03 deri më 18 Janar 2019, Kryqi i Kuq i RMV implementoi projektin e pushimit dhe rekreacionit falas për fëmijët e familjeve në rrezik social, fëmijët përfitues të shtesës së veçantë dhe të të drejtave të tjera të MPPS. 380 fëmijë u përfshinë me projektin e pushimit falas në Pushimoren "Begova Korija" në Krushëvë. Kryqi i Kuq u angazhua në këtë aktivitet të projektit me 23 vullnetarë. Në bashkëpunim me MPPS ky projekt u implementua gjithashtu në periudhën e verës. U angazhuan 32 vullnetarë - edukatorë dhe shpëtimtarë të ujت të organizatave komunale të Kryqit të Kuq të cilët gjatë muajit korrik dhe gusht

realizuan aktivitete me 705 fëmijë që qëndronin në Pushimoren e Fëmijëve "Majski Cvet" në Strugë.

Programi i asistencës personale për personat me aftësi të kufizuara. Kryqi i Kuq i RMV i mbështetur nga MPPS implementoi programin e asistencës personale për personat me aftësi të kufizuara, për jetesë të pavarur dhe të mëvetësishme të këtyre personave dhe pjesëmarrjen e tyre aktive në komunitet. Përmes KKQ të Shkupit dhe OKKK Manastir, Strugë, Strumicë, Gostivar, Negotinë dhe Kumanovë u ofruan shërbime për 105 përfitues nga ana e 83 asistentëve personalë që ishin angazhuar. Mbështetur nga Agjencia e Punësimit të RMV, u zbatuan trajnime të asistencës personale që kanë përfshirë 55 persona nga Manastiri, Strumica, Gostivari, Negotina dhe Kumanova, nga të cilët 10 kandidatë u mbështetën nga Organizatat Komunale të Kryqit të Kuq Strumicë, Kumanovë,



Pasqyra e shërbimeve të realizuara të asistencës personale për personat me aftësi të kufizuara në muajin dhjetor të vitit 2019

KOMUNA	Asistentët personalë të angazhuar	Numri i përfituesve
SHKUP	25	31
NEGOTINË	11	13
MANASTIR	11	16
STRUGË	4	6
STRUMICË	18	24
KUMANOVË	1	1
GOSTIVAR	11	12
VELES	2	2
Gjithsej	83	105



Manastir dhe Gostivar. Nga 15 Maji i vitit 2019 përmes Kryqit të Kuq të Qytetit të Shkupit, mbështetur nga Kisha Amerikane dhe UNDP, u zbatua një trajnim për gjithsej 14 kandidatë.

Kujdesi dhe mbështetja e personave të moshuar. Kryqi i Kuq implementoi Projektin Kujdesi për personat e moshuar në kushte shtëpiake me mbështetjen e Qytetit të Shkupit, Fondacionit Albiz dhe Bankës Shparkase, përmes Kryqit të Kuq Austriak. U angazhuan 10 vullnetarë të Kryqit të Kuq dhe 5 infermiere që ofruan shërbime sociale dhe shëndetësore për 200 të moshuar në kushte shtëpiake. Përmes Kryqit të Kuq të Qytetit të Shkupit në vazhdimësi u implementuan aktivitetet programore për personat e moshuar në qendrat ditore të personave të moshuar që japid ndihmë në kushte shtëpiake, me lokale në SHOH "Dare Xhambaz", në Organizatën Komunale të Kryqit të Kuq Çair, si dhe në ambientet e SHF në Komunën e Sarajit. Gjithashtu u implementuan aktivitete përmes Qendrës Ditore në Gazi Babë. Në nivel më i madhi u realizuan gjithsej mesatarisht 2320 vizita. Përmes klubeve të personave të moshuar që funksionojnë përmes Organizatave Komunale të Kryqit të Kuq Kriva Pallankë, Negotinë dhe Prilep, u implementuan aktivitete të përshtatshme të plakjes aktive dhe të shëndetshme.

Përmes shërbimit Qendra e Kujdesit e Kryqit të Kuq të Qytetit të Shkupit u implementuan dy trajnime të certifikuara për kujdestarë të personave të moshuar dhe të pafuqishëm. Trajnim i parë filloi më 4 mars dhe u mbështet nga qyteti i Vjenës, ku u trajnuan 14 kandidatë. Trajnim i dytë, i mbështetur nga HERA, filloi më 17 Shtator dhe u trajnuan 10 kandidatë. Kjo kontribuoi në cilësinë më të mirë të jetës së 54 personave të moshuar dhe të pafuqishëm, dhe sigurimin e mbështetjes së familjeve të tyre duke ofruar shërbime të kujdesit me ndi-

hmën e 44 kujdestarëve të angazhuar. Mbështetur nga qyteti i Vjenës janë trajnuar 80 vullnetarë dhe ekspertë të plakjes së shëndetshme. Është zbatuar një studim fizibiliteti – Hulumtimi i mundësive të vendosjes së Butonit për urgjencat dëshiruese të tjera mbështetëse të personave të moshuar në RMV, me mbështetjen e KK Austriak, Agjencisë Austriake të Zhvillimit dhe KK të Zvicrës. Janë realizuar 47 teste skriningu për detektimin e hershëm të demencës për persona të moshës mbi 60 vjeç, me mbështetjen e Bankës Shparkase. Ministria e Arsimit dhe Shkencës verifikoi Kryqin e Kuq të RMV si organizatë për zbatimin e programeve të trajnimit të kujdestarëve për persona të moshuar dhe të pafuqishëm në komunat Prilep, Strumicë, Gostivar, Ohër, Strugë dhe Negotinë. Nga 26 shtatori, përmes OKKK Prilep, filloj trajnimi i kujdestarëve ku u certifikuan gjithsej 16 kandidatë. Gjatë muajit dhjetor, një lloj i tillë trajnimi filloj gjithashtu përmes OKKK Ohër ku u përfshinë 13 kandidatë.

Bashkëpunimi rajonal. Në kuadër të Projektit Rajonal "Ndërmarrja e aksionit për përfshirjen sociale të personave të moshuar", nga 25 deri 27 Janar të vitit 2019 në Strugë u mbajt punëtoria finale e organizuar nga Kryqi i Kuq i RMV dhe Shoqata "Humanost", partnerë të projektit në Maqedoninë e Veriut. Qëllimi ishte rrumbullakimi i implementimit trevjeçar të Projektit të financuar nga Bashkimi Evropian, Agjencia Austriake e Zhvillimit dhe Kryqi i Kuq Austriak, dhe të koordinuar nga Kryqi i Kuq i Serbisë, në pesë vende të Ballkanit Perëndimor. U prezantuan rezultatet e arritura të

Projektit në Maqedoninë e Veriut. Përfaqësues të shoqatave të qytetarëve prezantuan rezultatet e 12 aktiviteteve të përfshirjes sociale të personave të moshuar në komunitete.

Socializimi i fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara.

Kryqi i Kuq i RMV në bashkëpunim me Entin e Veprimitarë Sociale, njëmbëdhjetë vjet të shtë duke implementuar aktivitete për përmirësimin e socializimit të fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara. Në janar u nënshkrua një marrëveshje donacioni me Bankën Komerciale SHA Shkup, e cila mbështet aktivitetet e projektit përmes KKQ të Shkupit dhe OKKK Prilep, Kavadar, Gostivar, Veles, Dellçevë, Dibër dhe Kërçovë, në bashkëpunim me qendrat ditore të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe qendrat e punës sociale. Nga 29 deri 31 Mars të vitit 2019, në Strugë u zhvillua një punëtori edukative me 30 vullnetarë të rinj të Kryqit të Kuq, përfaqësues të qendrave ditore, ku u rishikuan dhe miratuan planet lokale të veprimit. Gjatë vitit u zbatuan punëtori kreative, aktivitete edukative, aktivitete rekreative me fëmijët e qendrave ditore dhe fëmijët në familjet kujdestare dhe në qendrën ditore për aftësi të kufizuara nga Shkupi.

Trajnime të ndërmarrësisë sociale. Kryqi i Kuq, në bashkëpunim dhe me mbështetjen e Public dhe CEED, mundësoi ndjekjen e dy trajnimeve të zhvillimit të ndërmarrjeve sociale ku morën pjesë nga dy punonjës dhe vullnetarë të Organizatave Komunale të Kryqit të Kuq Prilep, Manastir, Ohër, Strugë, Kërçovë, Resnjë, Dibër dhe Krushevë. Qëllimi i edukimit ishte forcimi i kapacitetit të Shoqatës Nacionale për zhvillimin

e aktiviteteve ekonomike dedikuar qëllimeve sociale. Në thirrjen e hapur të Public dhe CEED drejtuar organizatave pjesëmarrëse në trajnimet, Organizata Komunale e Kryqit të Kuq Manastir fitoi një grant mbështetës për hapjen e një ndërmarrje sociale (paketim të sheqerit për nevoja të kafeneve). Kryqi i Kuq Manastir përfshirjet e funksionimin e ndërmarrjes sociale integroi në punë një të pastrehë.

Lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Me mbështetjen e Agjencisë së Rinisë dhe Sportit u zbatua Projekti "Të rinjtë në luftë kundër trafikimit të qenieve njerëzore". Qëllimi i aktiviteteve të projektit ishte forcimi i kapacitetit të Shoqatës Nacionale dhe ngritja e vetëdijesimit të rinisë për t'u mbrojtur nga trafikimi i qenieve njerëzore. Projekti u zbatua përmes Organizatave Komunale të Kryqit të Kuq Negotinë, Sveti Nikole dhe Veles. Në kuadër të Projektit u zhvilluan dy punëtori të edukimit të bashkëmoshatarëve për të rinj dhe u realizua një teatër-forum. U zhvilluan 27 punëtori preventive të edukimit për të rinj dhe tre teatro-forum në bashkëpunim me OJQ "Rubikon", ku morën pjesë gjithsej 814 nxënës të shkollave filllore dhe të mesme, prindër dhe përfaqësues të institucioneve lokale.

Në periudhën 11-14 Nentor të vitit 2019, organizuar nga Zyra Rajonale e Federatës Ndërkombëtare të Evropës në Budapest, u zhvillua punëtoria në temën "Mbrojtja, mos-diskriminimi në lidhje me gjininë dhe përfshirja e përqendruar veçanërisht në trafikimin e qenieve njerëzore në kontekst të migracioneve". Në këtë punëtori morën pjesë dy përfaqësues të Kryqit të Kuq të RMV. Qëllimi i edukimit ishte forcimi i kapacitetit të shoqatave nacionale evropiane për të njohur dhe reaguar në shenjat e trafikimit të qenieve njerëzore. Kryqi i Kuq shënoi 18 tetorin duke organizuar punëtori të edukimit të bashkëmoshatarëve për të rinj në shkolla filllore dhe të mesme përmes Kryqit të Kuq të Qytetit të Shkupit dhe 23 OKKK. U përfshinë mbi 700 nxënës të shkollave filllore dhe





të mesme dhe përfaqësues të Kryqit të Kuq. Në periudhën 5-6.03.2019 është marrë pjesë në trajnimin për parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore, organizuar nga Kryqi i Kuq i Serbisë, në Zllatibor. Janë shkëmbyer vegla dhe përvaja për aktivitetet preventive me nxënës për luftën kundër traffikimit të qenieve njerëzore.

Java e Solidaritetit. Nga 15 deri 21 Prill u shënuan "Java e Solidariteti" me moton: "Kontributi juaj - ndihmë e rëndësishme". Kryqi i Kuq organizoi një aksion grumbullimi për të zgjuar ndjenjën e humanizmit, reciprocitetit dhe solidaritetit tek qytetarët me qëllim të sigurimit të ndihmës së duhur për kategoritë më të rrezikuara të popullsisë. Në kuadër të Javës u organizua gjithashtu aksioni "Nga shtëpia në shtëpi" në të cilin vullnetarët e Kryqit të Kuq vizituan qytetarët në shtëpitë e tyre, ndërsa ata dhuruan mjete. Nga aksionet është siguruar një ndihmë prej 384.000 denarësh, me të cilat është blerë ushqim dhe është grumbulluar 7.900 kg. ushqim dhe 13.400 kg. veshmbathje. Në këto aksione janë përfshirë 695 vullnetarë të Kryqit të Kuq. Ndihma është distribuuar në mbi 1.800 familje në rrezik social. Në kuadër të Javës, më 16 Prill, Kryqi i Kuq në 10 komuna iu bashkua aksionit humanitar "Ushq 10.000" organizuar nga Shoqata "Të gjithë të ngopur", i cili siguroi gjithsej 6.000 kg. ndihmë në ushqim për popullsinë e prekshme.

Dita Ndërkombëtare dhe Java e Kujdesit të Personave të Moshuar. Kryqi i Kuq shënoi 1 Totorin – Ditën Ndërkombëtare të Personave të Moshuar. U organizuan punëtori edukative, kreative dhe informative për qytetarët e moshuar. Nga 18 deri 24 Nëntor u shënuan Java e Kujdesit të Personave të Moshuar, me moton "Të gjithë jemi fëmijët e tyre". U organizuan aktivitete të ndryshme në të cilat u

përshinë mbi 4000 persona të moshuar.

Java e Luftës Kundër Urisë. Kryqi i Kuq, me rastin e Javës së Luftës Kundër Urisë, nga 16 deri 22 Tetor organizoi një fushatë me moton "Mendoni edhe për ne". U organizuan aksione humanitare për sigurimin e donacioneve në para dhe ushqim me odat ekonomike, kompanitë, institucionet arsimore-edukative, shoqatat e qytetarëve dhe qytetarët. Në këtë fushatë u siguruan 749.000 denarë që janë dedikuar për të blerë ushqim. Nga ushqimi i grumbulluar dhe i blerë u sigurua një sasi e përgjithshme prej 18.335 kg. dhe ajo iu shpërndau

*Të edukuar 30 vullnetarë
të rinj të Kryqit të Kuq për
mbështetjen e fëmijëve me
aftësi të kufizuara në 8
qendra ditore.*

Java e Solidaritetit

**Është siguruar gjithsej ndihmë
në ushqim - 7.900 kg. dhe
13.400 kg. veshmbathje**

**Është distribuar ndihmë në
mbi 1.800 familje në rrezik
social.**

**Janë përfshirë 695 vullnetarë
të Kryqit të Kuq**

2.463 personave në rrezik social. Në këto aksione u përfshinë 769 vullnetarë të Kryqit të Kuq.

Pikat e Të Pastrehëve. Pika e Të Pastrehëve në Momin Potok në Shkup, në periudhën Janar-Dhjetor të vitit 2019 ka punuar çdo të mërkurë dhe të premte. Ditëve të premte ajo është vizituar mesatarisht nga 70 të pastrehë. Personat e pastrehë kanë marrë shërbime floktarie/berberi, kontolle dhe këshilla të mjekut, si dhe barna, ushqim të ngrrohtë dhe piye, bisedë profesionale-këshillëdhënëse me një punonjës social dhe një psikolog. Strehimorja e përkohshme u hap në periudhën e vitit kur temperaturat ishin të ulëta në mënyrë ekstreme për personat e pastrehë të cilët kishin probleme shëndetësore dhe psiko-sociale me qëllim që të tregohet kujdes për ta deri në kapërcimin e gjendjes së tyre. Në një periudhë të vitit kur temperaturat ishin në mënyrë ekstreme të ulëta, funksionoi gjithashu Pika e Të Pastrehëve në Strumicë ku u tregua kujdes për 3 persona, ndërsa në Pikën në Manastir, 5 persona të pastrehë kanë marrë ndihmën e duhur.

“Vakt për të gjithë”. Kryqi i Kuq i RMV është partner projekt i implemtimin e Projektit “Sfida e zgjidhjes novatore për sigurimin e - një Vakti për të gjithë”, koordinuar nga Shoqata “Eja Maqedoni”. Qëllimi i Projektit ishte shfrytëzimi i tepricës së tregut për të siguruar ushqime nutritive për kategoritë e ndryshme të qytetarëve të rrezikuar në pikëpamje sociale. Në një periudhë gjashtë mujore u zbatua pilotimi i modeleve të distribucionit të ushqimit tek qytetarët e rrezikuar në pikëpamje sociale në Shkup, Kumanovë dhe Prilep. Me këtë ndihmë u mbuluan 10 familje nga Shkupi dhe nga 5 familje nga Prilepi dhe Kumanova. Vullnetarë të Kryqit të Kuq





të Qytetit të Shkupit dy herë në javë kanë shpërndarë vakte për 50 persona të pastrehë në Pikën e Të Pastrehëve në Shkup.

Aksioni humanitar “Le të ndajmë gjëzim”.

Kryqi i Kuq në bashkëpunim me EVN Maqedoni organizoi një aksion të përbashkët humanitare “Le të ndajmë gjëzim”. Aksioni u zbatua nga 23 deri 26 Dhjetor dhe u siguruan 500 dhurata të Vtitit të Ri përfshirë fëmijët e familjeve në rrezik social dhe fëmijët me aftësi të kufizuara. Dhuratat u dhanë në ngjarje të përshtatshme, organizuar nga Kryqi i Kuq i Qytetit të Shkupit dhe Organizatat Komunale të Kryqit të Kuq Strumicë, Manastir, Gostivar, Kumanovë, Kërçovë dhe Shtip, në bashkëpunim me përfaqësues të EVN-së në komunat në të cilat u realizua aksioni.

Fushata “Mondoni edhe për ne”

**Janë mbledhur gjithsej
749.000 denarë dedikuar për
ndihmë në ushqim**

**Është grumbulluar dhe është blerë
gjithsej 18.335 kg. ushqim**

**Është shpërndarë ndihmë
tek 2.463 persona
në rrezik social**

**Janë përfshirë 769
vullnetarë të
Kryqit të Kuq**



GATISHMËRIA DHE VEPRIMI NË KATASTROFA

Aktivitetet e gatishmërisë dhe reagimit në rast katastrofash në vitin 2019 kishin për qëllim sigurimin e një reagimi ndaj situatave të ndryshme të jashtëzakonshme dhe katastrofave, si vala e ftohtë, vala e nxehtë dhe zjarret pyjore dhe kriza migruese në kuadër të sistemit të menaxhimit të krisave dhe mbrojtjes dhe shpëtimit. Në vazhdimësi u punua në përmirësimin e kapacitetit material dhe njerëzor dhe në krijimin e një Qendre operative të gatishmërisë dhe reagimit në katastrofa për të siguruar një reagim të shpejtë dhe efektiv në rast katastrofash. Shoqata Nacionale punoi gjithashtu në ngritjen e vetëdijesimit publik për pasojat e mundshme të katastrofave dhe në nxitjen e institucioneve arsimore për t'u vetëmbrojtur dhe mbrojtur nga fatkeqësitë dhe katastrofat.

Punëtoria Ndërkombëtare në Ohër. Përfaqësues të Kryqit të Kuq të RMV, më 14.05.2019 morën pjesë në Punëtorinë Ndërkombëtare “Menaxhimi i rreziqeve dhe krijimi i një sistemi efikas të shpëtimit – bazë e një turizmi të sigurt aventurist” – në kuadër të Projektit të Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA midis Maqedonisë dhe Shqipërisë, i zbatuar nga Organizata Komunale e Kryqit të Kuq Ohër dhe Qendra Kombëtare e Mjedisit Jetësor, Turizmit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm të Shqipërisë. Punëtoria u zhvillua në Ohër dhe aty morën pjesë tur-operatorë, shoqata bjeshkatarësh, udhëzues (guida), shërbime të shpëtimit të ujit dhe institucione shtetërore të Shqipërisë dhe Maqedonisë.

Trajnimi Ndërkombëtar në Mal të Zi. Përfaqësues të Kryqit të Kuq të RMV, në periudhën nga 28 deri 31 Totor, në Sutomore, Mal të Zi, morën pjesë në trajnimin ndërkombëtar të gatishmërisë dhe reagimit në katastrofa. Trajnimi u organizua nga Federata Ndërkombëtare për zbatimin e vlerësimit dhe përmirësimin e reagimit në katastrofa.

Trajnimi i Menaxhimit të Kampit. Më 04.04.2019 u zhvillua një trajnim me temën Menaxhimi i Kampit, Vlerësimi i Nevojave Humanitare dhe Ndhima e parë. U punua në organizimin e kapaciteteve të akomodimit në një vendbanim-kamp, rregullat dhe parimet dhe çështjet kryesore në rast nevoje për nevoja humanitare në situata të ndryshme me rastin e zbatimit të vlerësimit. Në këtë trajnim morën pjesë 15 vullnetarë.

Trajnimi i Programit CASH. Organizuar nga Federata Ndërkombëtare, në periudhën 15-17.07.2019, në Beograd u zhvillua Trajnimi i Programit CASH për mbështetjen e përdoruesve të parave të gatshme për anëtarët e Ekipit Rajonal të Reagimit në Katastrofa, gjegjësisht për procesin e zbatimit të veglës CASH në praktikë në rast katastrofash. Në këtë trajnim morën pjesë përfaqësues të disa shoqatave nationale nga Evropa.

Trajnimi i ekipave rajonale. Në periudhën 02-10.12.2019, përfaqësues të Kryqit të Kuq të RMV, në Stamboll, Turqi, morën pjesë në Trajnimin Ndërkombëtare të Ekipave Rajonale të Reagimit në Katastrofa, organizuar nga Federata Ndërkombëtare dhe Gjysmëhëna e Kuqe Turke. Në trajnim morën pjesë 24 përfaqësues të shoqatave nationale. Qëllimi kryesor i trajnimit ishte përgatitja e kuadrit të ardhshëm profesional të Ekipit Rajonal.

Analiza e të dhënavë humanitare. Në periudhën 05-09.12.2019, një përfaqësues i Kryqit të Kuq mori pjesë në trajnimin ndërkombëtar të analizës së të dhënavë humanitare, organizuar nga Federata Ndërkombëtare dhe Kryqi i Kuq i Italisë, që u zhvillua në Milano, Itali. Qëllimi kryesor i kursit ishte sigurimi në kohë i identifikimit të nevojave parësore ndër-sektoriale pas një katastrofe ose krize.

Plani i vlerësimit të shpejtë të nevojave urgjente. Nga 05-09.12.2019, një vullnetar i Kryqit të Kuq të RMV mori pjesë në trajnimin ndërkombëtar për krijimin e një plani të shpejtë të vlerësimit të nevojave urgjente në katastrofa, në Milano, Itali, organizuar nga Federata Ndërkombëtare dhe Kryqi i Kuq i Italisë.





Ndihma e Parë Psikologjike. Në periudhën 22-24.03.2019, në Strugë u zhvillua punëtoria e shkëmbimit të rezultateve dhe zhvillimit të konceptit të mëtejshëm për forcimin e kapacitetit të Shoqatës Nationale në kuadër të Projektit "Ndihma e parë psikologjike dhe mbështetja psiko-sociale", mbështetur nga Kryqi i Kuq Austriak. Në këtë punëtori morën pjesë 29 përfaqësues të Kryqit të Kuq të RMV.

Punëtoria ndërkontinentale në Serbi. Organizuar nga Kryqi i Kuq i Serbisë dhe Kryqi i Kuq Austriak, në periudhën 11-13 dhjetor të vitit 2019, në Beograd u mbajt një takim pune i koordinuesve të gatishmërisë dhe reagimit në rast katastrofash me qëllim të përzgjedhjes së fushave tematike në planin e menaxhimit të katastrofave për përgatitjen e një aplikimi të projektit.

Ushtimi i simulimit "Reagimi i Përbashkët 2019". Më 19 korrik u zhvillua ushtimi operativ ndërveprues i mbrojtjes dhe shpëtimit "REAGIMI I PËRBASHKËT 2019" në rajonin e zonës industriale – Milladinovci, fshati Petrovec, fshati Bunarxhik. Ushtimi u organizua dhe monitorua nga Qendra e Trajnimit të Drejtorisë së Mbrojtjes dhe Shpëtimit ku morën pjesë të gjitha institucionet që janë pjesë e sistemit të reagimit në katastrofa në RMV. Kryqi i Kuq në këtë ushtrim kishte përdetyrë të kujdeset për të lënduarit nga një shpërthim i simluar dhe për transportin e tyre tek qendra e triazhit. Morën pjesë 16 përfaqësues të Kryqit të Kuq.

Vala e ftohtë 2019. Gjatë Valës së ftohtë në periudhën nga 16.12.2018 deri 13.01.2019 në Shkup, Pika e Të Pastrehëve siguroi bujtje për personat e pastrehë me 292 bujtje dhe shtrojë të pastër, veshmbathje, vakte ushqimore dhe ndihmë mjekësore. Është distribuuar ndihmë humanitare në fshatrat Rahoviç dhe Zovic, dhe në bashkëpunim me ARMV është ofruar ndihmë për fshatrat e rrëthinës së Shkupit, Brezë dhe Malinë. OKKK Manastir ofroi ushqim dhe higjienë për familjet e rezikuara në pikëpamje sociale dhe kujdes për personat e pastrehë në Pikën e Të Pastrehëve në OKKK Manastir.

Ndihmë humanitare u distribuua gjithashtu tek familjet e rezikuara në fshatrat Gjavato, Rotino, Mallovishtë, Capari, Dolenci, Bratindoll, Bukovë, Kérstoar, Oreovë, Staravinë, Novaci, Beranci, Sekirani dhe Kukureçani, si dhe në territorin e qytetit të Manastirit. Në Pikën e Të Pastrehëve u ofruan gjithashtu vakte të ngrohta dhe çaj. Është dhënë çaj i ngrohtë gjithashtu nëpër rrugët e Manastirit. OKKK Kërçovë nga 14 deri 16 janar siguroi ndihmë për personat e moshuar, të sëmurë dhe të pafuqishëm, personat në rrezik social në fshatrat Orlancë, Dushogubicë, Llavçani dhe Dolencin e Manastirit që ishin më të prekur nga reshjet e borës.

Vala e nxehthë. OKKK Veles mori pjesë në përbalimin e zjarreve pyjore të verës. Tek Liqeni Milladost u distribuuan 220 lanc-paketa, 680 shishe me ujë dhe 200 shishe me lëng, për zjarrin në Oraovec u distribuuan 100 lanc-paketa dhe 100 shishe me ujë. OKKK Manastir siguroi 24 pako me ujë dhe sandviçë në bashkëpunim me vetëqeverisjen lokale. OKKK Radovish me një Shtab Rajonal të Krizës siguroi mbështetje për kapërcimin e pasojave të zjarreve lokale. OKKK Kisella Voda siguroi distribucionin e ushqimit dhe higjienës tek një familje e prekur nga zjarri në fshatin Moranë. OKKK Gjevgjeli siguroi ndihmë humanitare për familje të prekura nga zjarri në 6 banesa të një ndërtese banimi. Më 10.07.2019 pas stuhisë së madhe në Rajonin e Pre-spës, OKKK Resnjë distribuoi ujë në shishe dhe ndihmoi në pastrimin e terrenit.

Tërmeti catastrofal në Durrës, Shqipëri 2019. Kryqi i Kuq i RMV pas tërmetit catastrofal në Shqipëri më datë 26.11.2019 ndërmori një sërë aktivitetesh për të siguruar mbështetje materiale dhe financiare për popullsinë e goditur nga tërmeti. Ndihma filloset humanitare përbëhej nga:



Ndihma humanitare	Sasia	Vlera në EURO
Thasë gjumi	500	7.500,00
Batanije	1000	5.000,00
Krevate gjumi	50	2.500,00
Pako ushqimore	100	2.500,00
Pako higjenike	100	2.500,00
GJITHSEJ		20.000,00

Ndihma financiare për Kryqin e Kuq të Shqipërisë: 10.000 euro; Ndihma materiale në shumë 20.000 euro; Mobilizimi i ekipeve mjekësore dhe logistike në gatishmëri: 20 persona.

Pas tërmetit, Kryqi i Kuq i RMV me 4 ekspertë të gatishmërisë dhe reagimit në katastrofa vizitoi zonën e goditur në Shqipëri për të bërë vlerësimin filletar të nevojave dhe për të dérguar ndihmë materiale. Në bashkëpunim me operatorët telefonikë u vunë në dispozicion gjithashtu numrat e telefonit të donacioneve për përdoruesit e Telekomit të Maqedonisë 143 400 dhe për përdoruesit e A1 Maqedoni 143 400 për dhurimin e mjeteve financiare nga individë. Donacione nga persona dhe kompani janë grumbulluar gjithashtu nga llogaria e Fondit të Solidaritetit: Deri më 17.12.2019 janë mbledhur gjithsej 9.416.304,00 denarë nga Fondi i Solidaritetit të Kryqit të Kuq si dhe nga numrat e telefonit të donacioneve. Përveç kësaj, më 30.11.2019 janë siguruar 3590 batanije dhe i janë dorëzuar Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë.

Vegla Ueb. “Gjenerata e ardhshme e sistemit të komandimit në incidente” është një vegël e bazuar në ueb, e dizajnuar për bashkëpunim më efikas dhe më efektiv dhe ndërveprueshmëri ndërmjet agjencive në raste urgjencash dhe katastrofash. Me vendim të Qeverisë së RMV kjo vegël është integruar në sistemin e menaxhimit

të krizave dhe të gjitha institucionet e përfshira në sistem duhet ta përdorin atë. Në vitin 2019 KKRMV mori pjesë, përgatiti dhe realizoi shumë aktivitete për integrimin e veglës në punën e tij.

Reagimi Nacional 2019. Ushtimi “Reagimi Nacional” është një ushtrim gjithëpërfshirës që përfshin sektorin civil dhe ushtarë, gjegjësisht të gjitha institucionet që merren me përballimin e katastrofave të shkaktuara nga natyra dhe njeriu. Ushtrimi në të cilin mori pjesë Kryqi i Kuq u organizua nga Komanda e Bashkuar Operative e Armatës së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Bashkëpunimi me Njësinë e Vetëqeverisjes Lokale të Karposhit. Më 30 gusht në Strugë u zhvillua trajnimi për menaxhimin e katastrofave me theks në përblyjet, për Njësinë e përfaqësuesve të Vetëqeverisjes Lokale Karposh. Pjesëmarrësit në këtë trajnim patën mundësinë të njihen me aktivitetet e ndërmarra të Kryqit të Kuq gjatë përblyjeve në vitin 2016 që goditën Rajonin e Shkupit dhe Tetovës.

Bashkëpunimi me Ministrinë e Mbrojtjes dhe Fakultetin Filozofik. Një përfaqësues i Kryqit të Kuq të RMV më 30.10.2019 mori pjesë në Seminarin “Menaxhimi i krizave dhe situatave të krizës”. Seminarin është rezultat i bashkëpunimit të ndërsjellë me Ministrinë e Mbrojtjes dhe Fakultetin Filozofik, në fushën e organizimit të aktivitetave të përbashkëta në lidhje me sektorin e mbrojtjes dhe sigurisë në vend.

Distribucioni i ndihmës humanitare me Gjysmëhënët e Kuqe Turke. Më 16 maj të vitit 2019, Kryqin e Kuq të RMV e vizitoi një delegacion dy anëtarësh i Gjysmëhënës së Kuqe Turke me qëllim të sigurimit të ndihmës humanitare përkategorinë e prekshme të personave në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Përfaqësues të Gjysmëhënës së Kuqe Turke blenë pako ushqimore të cilat së bashku me përfaqësues të Kryqit të Kuq të RMV i shpërndanë në Rajonin e Radovishit, në Komunën e Çairit, në fshatrat përreth Shkupit dhe në Komunën e Gostivarit.

het ndryshimeve klimatike, ndihmës në rast përbërbytjesh, thatësish, si dhe valëve të ftohta dhe të nxeha që mund të priten në të ardhmen. Aktivitetet e projektit po zbatohen në institucionet arsimore. Aktivitetet e deritashme të realizuara janë: përgatitja e një katalogu resursesh; pjesëmarrjet në takime ndërkombëtare; përgatitja dhe përshtatja e platformës onlajn; përshtatja e moduleve të trajnimit onlajn dhe trajnimi "sy më sy"; takimet dhe prezantimet e diseminimit me institucionet.



Vizita e një delegacioni të Gjysmëhënës së Kuqe Turke.

Më 28.10.2019, Kryqin e Kuq e vizitoi një delegacion i Gjysmëhënës së Kuqe Turke dhe u siguria ndihmë humanitare për SHF "Mustafa Kemal Ataturk" në Koxhaxhik, Zhupë, Dibër. GJK Turke dhuroi 300 palë çizme, 250 palë këpucë sportive, 300 xhaketa dhe 300 komplete pajisjesh shkollore.

Ndihma humanitare. Kryqi i Kuq i RMV në bashkëpunim me Gjysmëhënën e Kuqe Turke distribuoi ndihmë humanitare në veshmbathje për 1815 familje, në vlerë prej 85.000 eurosh. Ndihma humanitare u distribua në: Rajonin e Shkupit 300 pako, Rajonin e Radovishit 1100 pako, Rajonin e Gostivarit 250 pako dhe Rajonin e Vallandovës 165 pako.

Projekti "Shkolla dhe Kopshte Fëmijësh të Sigurta". Projekti "Shkolla dhe Kopshte Fëmijësh të Sigurta" i mbështetur finanziarisht nga Programi ERASMUS+ i refero-

Projekti me Federatën Ndërkombëtare të KK/GJK.

Gjatë muajit Tetor filltoi realizimi i Projektit "Ndërtimi i kapaciteteve të komunikimit dhe koordinimit të gatishmërisë dhe reagimit efikas në Evropën Juglindore" mbështetur nga Federata Ndërkombëtare e KK/GJK. Në kuadër të projektit do të përgatitet/përmirësohet një Qendër Operative në rast katastrofash, POS përfunksionimin e saj si dhe ushtrimet e përbashkëta të simulimit në nivelin rajonal përmirësimin e koordinimit dhe reagimit të përbashkët.

Siguria e ujtit

Kursi i instruktorëve dhe shpëtimtarëve të ujërave të hapura. Organizata Komunale e Kryqit tē Kuq Ohër në bashkëpunim me Kryqin e Kuq tē RMV, në periudhën nga 03.07.2019 – 10.07.2019 zhvilloi një kurs pér instruktorë dhe shpëtimtarë të ujërave të hapura (lumenj, liqene dhe dete). Licencën e instrukturit nē ujëra të hapura (lumenj, liqene dhe dete) e morën 6 veta dhe një kandidat si instruktor demonstrues, licencën e shpëtimtarit nē ujëra të hapura e morën 7 kandidatë nga tē cilët 4 kandidatë janë nga Ohri, 1 nga Struga, 1 nga Prilepi dhe 1 nga Manastiri. Licencën e shpëtimtarit tē ri nē ujëra të hapura e morën 7 kandidatë nga tē cilët 3 nga Struga, 2 nga Ohri, 1 nga Manastiri dhe 1 nga Shkupi.

OKKK Veles. Më 19 janar, nē “Ujët e Bekuar”, Ekipi i Sigurisë së Ujit i OKKK Veles u angazhua nē Manifestimin pér tē siguruar rreth 60 qytetarë tē cilët nē afërsi tē “Mallo Movçe” (Urës së Vogël) u hodhën nē ujërat e lumi Vardar pas kryqit. OKKK mori pjesë gjithashtu nē Maratonën Ndërkombëtare tē Notit nē Ligenin Mlladost ku morën pjesë 10 persona tē Ekipit tē Sigurisë së Ujit që u kujdesën pér sigurinë e garuesve tē Maratonës. Ekipi i Sigurisë së Ujit mori pjesë nē sigurimin e Garës Shtetërore nē Kajke nē Ujëra tē Rrëmbyeshëm ku ishin tē pranishëm tre përfaqësues tē Kryqit tē Kuq.



Kryqi i Kuq i Qytetit të Shkupit – Qendra e Sigurisë së Ujit. Qendra e Sigurisë së Ujit e Kryqit tē Kuq i Qytetit të Shkupit u angazhua nē sigurimin e 7 pishinave dhe 1 Akua Parku. Këtë vit u angazhuan mbi 60 vullnetarë. Janë regjistruar mbi 900 intervenime brenda dhe jashtë zonës ujore (intervenime tē lehta dhe serioze, tē mbytur aktivë, transporti deri tek institucioni mjekësor etj.) Qendra e Sigurisë së Ujit e Kryqit tē Kuq i Qytetit të Shkupit së bashku me instruktorët e saj, gjatë vitit organizoi 5 kurse tē shpëtimtarëve tē ujtit ku morën pjesë 46 veta, 24 veta morën licencën e re tē shpëtimtarit nē ujë dhe 6 veta i ripërtërinë licencat.

OKKK Ohër – Qendra e Sigurisë së Ujit. Në periudhën nga 01.07.2019 - 31.08.2019, Qendra e Sigurisë së Ujit e Kryqit tē Kuq Ohër u angazhua nē 16 zona tē organizuara tē larjes nē bregun e Ligenit tē Ohrit dhe 4 pishina me gjithsej 35 shpëtimtarë tē ujtit. Deri më 15.09.2019 janë regjistruar gjithsej 1174 intervenime brenda dhe jashtë zonës ujore. Koordinuesit e Qendrës së Sigurisë së Ujit çdo ditë ishin nē patrullë tē rregullt me një barkë shpëtimi me qëllim tē parandalimit, intervenimit dhe koordinimit më tē mirë tē shpëtimtarëve nē plazhet e siguruara rreth bregut.

OKKK Manastir. Gjatë sezonit së verës OKKK Manastir bëri sigurimin e zonave tē larjes së Ligenit tē Prespës. U mbuluan 4 plazhe me 8 shpëtimtarë tē ujtit. Është bërë një intervenim ndaj një notari tē lënduar seriozisht.



Siguria malore

OKKK Ohër. Gjatë vitit, u rrumbullakua realizimi i Projektit dyvjeçar “Rajoni i Liqenit të Ohrit – Destinacion i sigurt i turizmit aventurist” financuar nga Bashkimi Evropian përmes Programit IPA të Bashkëpunimit Ndërkufitar me Shqipërinë, dhe u nënshkrua një marrëveshje për një Projekt të ri tregjeçar “Mundësitet e reja të turizmit aventurist të sigurt dimëror”, që është vazhdim i aktiviteteve. Me projektin e ri, është parashikuar blerja e dy automjeteve të specializuara për transportimin e të lënduarve në kushte dimërore. Janë realizuar gjithashtu 6 sigurime të ngjarjeve sportive-rekreative në mal dhe 8 intervenime shpëtimi.

OKKK Manastir. Gjatë vitit është marrë pjesë në katër manifestime (sigurimin e Pelister DownHilltrail – garë ekstreme me bicikleta, sigurimin e ngjitjes natën në Kërcin të Madh, Rostushë, Krali Marko Trail Prilep – një garë nëpër një shteg të trasuar 16 km., sigurimin e Marshit Bjeshkatar me rastin e 15 Janarit – Ditës së Sigurisë Malore, sigurimin e Marshit Bjeshkatar Dimitar Ilievski – Murato), dhe është marrë pjesë në ushtrimin simulues të gatishmërisë në katastrofa - Tërmete dhe Zjarre në SHMK “Jane Sandanski” – Strumicë, stërvitje.

OKKK Strumicë. Në periudhën nga 22 deri 25 Korrik, Organizata Komunale e Kryqit të Kuq Strumicë organizoi një Punëtori Ndërkombëtare Edukative me temën “Shpëtimi malor” në bashkëpunim me disa organizata, ku morën pjesë 54 vullnetarë të Kryqit të Kuq të disa organizatave komunale të Kryqit të Kuq të RMV dhe vullnetarë të Kryqit të Kuq Bllagoevgrad nga Bullgaria dhe Kryqit të Kuq Rakovica nga Serbia.

Ekipi i Shpëtimit Malor i Kryqit të Kuq të Qytetit të Shkupit. Ekipi i Shpëtimit Malor i Kryqit të Kuq të Qytetit të Shkupit, në vazhdimesi gjatë vitit me shpëtimtarë të trajnuar malorë në hapësirat e stacioneve të shpëtimit Vodno dhe Matka realizoi 155 ditë të rregullta kujdestarie (Vodno 116 ditë dhe Matkë 39 ditë). Gjithashtu, është bërë sigurimi i ngjarjeve sportive-rekreative malore, Maratonës së Shkupit, Ujet e Bekuar, ushtrimeve simuluese dhe të tjera, si dhe janë kryer 111 intervenime shpëtimi dhe intervenime të ndihmës së parë. Po ashtu, Ekipi i Shpëtimit Malor gjatë valës së ftohtë në bashkëpunim me ARM dorëzoi ndihmë humanitare për 300 persona në vendbanimet Tanushë, Brezë, Malinë, Rahovic, Luboten, Bllacë, Seta Petkë, Barovë, Çiflik, Sonje, Pobozhje.



VEPRIMTARIA SHËNDETËSORE-PREVENTIVE

Zvogëlimi i dëmeve të përdorimit të drogës. Projekti është dedikuar për personat – përdorues të drogës dhe po zhvillohet në territorin e tri organizatave komunale të KK Kërçovë, Veles dhe Prilep. Qendrat në Organizatat Komunale ofrojnë shërbime mjekësore, sociale dhe juridike për përfituesit. Përfituesit marrin gjithashtu pajisje sterile të injektimit si dhe këshilla rreth dëmeve të mundshme të shkaktuara nga përdorimi i pajisjeve jo sterile siç janë HIV/ SIDA dhe Hepatiti B dhe C. Në vitin 2019 janë mbuluar 639 klientë. Janë ofruar gjithashtu 3941 shërbime sociale për 362 persona. Në bashkëpunim me Institutin e Shëndetit Publik dhe OJQ HERA është zhvilluar këshillimi i besueshëm në terren dhe testimi në Prilep dhe Veles ku janë mbuluar 83 persona të popullsisë së synuar. Në Veles janë organizuar 42 punëtori kreative për risocializimin e personave duke përfshirë 156 përdorues. Tre përfaqësues të

ekipit në Prilep morën pjesë në realizimin e Projektit me OJQ HERA për sensibilizimin e popullsisë lokale dhe mbështetjen institucionale të Programeve të Parandalimit të HIV. Është mbajtur tryeza e rrumbullakët “Mbështetja institucionale dhe sensibilizimi i popullsisë për Programet e HIV-it” (19.03.2019) në Komunën e Prilepit.

Implementimi i Projektit “Shëndeti në komunitet – edukimi i bashkëmoshatarëve për parandalimin e sëmundjeve të transmetueshme seksualisht”. Mbështetur nga Federata Ndërkombëtare, në 20 OKKK është zbatuar Projekti me qëllim të ngritisë së vetëdijesimit të rinisë për parandalimin e sëmundjeve të transmetueshme seksualisht. Gjithsej janë trajnuar 48 edukatorë bashkëmoshatarësh të cilët kanë zbatuar 144 edukime bashkëmoshatarësh në shkolla fillore dhe të mesme dhe është mbuluar një grup i synuar prej 3819 veta.

Distribucioni i pajisjeve sterile dhe mbrojtjes:

57426 gjilpëra dhe 31 875 shiringa

12323 prezervativë, 5269 lubrikan-të dhe 3040 IEK

Mbrojtja e shëndetit në kushte ndryshimesh klimatike. Kryqi i Kuq në mënyrë aktive mori pjesë në punën e Komitetit Nacional të Ndryshimeve Klimatike dhe Komisionin e Ndryshimeve Klimatike dhe Shëndetit në Ministrinë e Shëndetit. Më 17 dhe 31 janar të vitit 2019 u kryen edukime të policisë kufitare për nevojat e policisë kufitare në kalimin kufitar Tabanoc, Rogaçevë dhe Jazhincë, si dhe personelit të Qendrës Pritëse Tabanoc. Trajnimet u ndoqën nga 45 veta. Temat u përqendruan në ndihmën e parë dhe vetë-ndihmën në pjesë të ngrira të trupit, hipotermi dhe komplikime. Një trajnim i tillë është mbajtur gjithashtu në muajin shkurt për nevojat e policisë kufitare në kalimin kufitar Kriva Pallankë dhe Pelince ku

morën pjesë 18 veta. Në kuadër të planit të miratuar të veprimit për valët e nxehta, Kryqi i Kuq ndërmori aktivitete për të mbrojtur popullsinë nga valët e nxehta. Organizatat Komunale të Kryqit të Kuq aktivizuan ekipe/vullnetarë për të dhënë ujë për popullsinë në periudhën nga ora 10-16 gjatë ditëve të valës së nxehtë. Vullnetarë të trajnuar dhe mjekë, me automjete të Kryqit të Kuq patrulluan nëpër lokacionet më frekuentues të Qytetit të Shkupit, duke dhënë ujë mineral dhe flaerë për qytetarët me këshilla të mbrojtjes nga vala e nxehtë. U angazhuan 76 vullnetarë dhe 33 ekipe. Gjatë muajit korrik në Shkup u dhanë 5.500 shishe me ujë.

Dita Botërore e Luftës Kundër Tuberkulozit – 24 Marsi.

Kryqi i Kuq shënoi Ditën Botërore të Luftës Kundër TBC me moton “Është koha... Për një botë pa Tuberkuloz”. Organizatat Komunale dhe KKQ të Shkupit zbatuan aktivitete për ngritjen e vetëdijesimit publik dhe ofrimin e njojurive rreth kësaj sëmundjeje. Në 14 OKKK u edukuan 460 veta në lidhje me atë se çfarë është TBC, simptomat e sëmundjes, parandalimi dhe mjeckimi. Më 18 mars 2019, Kryqi i Kuq i RMV dhe Barnatoret BETTY nënshkruan një memorandum bashkëpunimi në fushën e programeve shëndetësore-preventive. Më 24 mars në disa barnatore të Maqedonisë u vendos një material informativ-edukativ për TBC-në i Kryqit të Kuq të RMV që iu dha qytetarëve.

Java e Luftës Kundër Kancerit. Java e Luftës Kundër Kancerit u shënua nga 01-08 mars me moton “Së bashku do të kemi sukses”. U zhvilluan 39 ligjérata edukative nga doktorë vullnetarë të OKKK Resnjë, Gjevgjeli, Krushevë, Prilep, Ohër, Strugë, Veles, Kavadar, Kumanovë, Negotinë, Manastir dhe Shkup në shkolla fillore dhe të mesme, me anëtarë të klubeve rinore, shoqata të pensionistëve, organizata të punës dhe vullnetarë në organizatat komunale. U përfshinë 1130 veta. KKQ i Shkupit në bashkëpunim me Klubin Rinor vizitoi gratë që mjekohen në Klinikën e Onkologjisë në Shkup dhe u dhuroi atyre lule dhe dhurata me rastin e Festës së Gruas – 8 Marsit.

Java e Luftës kundër Sëmundjeve të Zemrës. Java u shënua nga 21-28 shkurt të vitit 2019 me moton “Zemra Ime, Zemra Jote”. Organizatat Komunale të Kryqit të Kuq përmes 57 ligjératave edukative për sëmundjet e zemrës shënuan këtë aktivitet në shkollat fillore dhe të mesme, me anëtarë të klubeve rinore, shoqata pensionistësh, organizata të punës dhe me vullnetarë të organizatave komunale. U përfshinë 2100 persona. KKQ i Shkupit në bashkëpunim me Klinikën “Zhan Mitrev” zhvilloi një punëtori me anëtarët e Klubit Rinor të cilët patën mundësinë të marrin informacion dhe këshilla të dobishme për shëndetin e tyre dhe shprehitë e shëndetshme.

Java e Luftës Kundër HIV/SIDA. Në periudhën nga 1-7 dhjetor, Kryqi i Kuq i RMV shënoi Javën e Luftës Kundër HIV përmes të gjitha OKKK dhe KKQSH. U organizuan 180 ngjarje të ndryshme: vendosja e stendave në vendet më frekuentuese; ligjérata edukative të bashkëmoshatarëve në shkolla fillore dhe të mesme; punëtori në të cilat u dhanë prezervativë, material promovimi dhe informativ, u ofrua informacion përvirusin HIV dhe mënyrën e bartjes së HIV/SIDA, parandalimin dhe testimini i HIV. Në këto ngjarje morën pjesë 4540 veta të grupeve të ndryshme të synuara. Qëllimi i këtyre ngjarjeve ishte ngritja e vetëdijesimit rreth preventivës së HIV dhe në të njëjtën kohë ulja e stigmës lidhur me njerëzit që jetojnë me virusin HIV.

Java e Luftës Kundër Tuberkulozit. Për të ngritur vetëdijesimin publik të popullsisë rreth parandalimit të tuberkulozit si sëmundje infektuese, njojhes së hershme, zbulimit në kohë dhe mundësive të mjekimit të tij, Kryqi i Kuq në periudhën nga 14-21 shtator të vitit 2019 shënoi Javën e Luftës Kundër Tuberkulozit. Gjatë Javës u realizuan 30 edukime përgrupë të ndryshme të synuara të rezikut në disa organizata komunale të Kryqit të Kuq të RMV dhe u përfshinë gjithsej 615 veta të grupeve të ndryshme të synuara





NDIHMA E PARË

**158 kurse falas
të rifreskimit
të ndihmës së
parë**

**3383 shoferë
me njohuri të
rifreskuara
të ndihmës së
parë.**

torike për ofrimin e ndihmës së parë për persona të lënduar në një aksident komunikacioni. Në këtë trajnim u aftesuan 13 ligjërues dhe 11 demonstrues. .

Fushata e Ndihmës së Parë. Më 11.07.2019 u mbajt një konferencë shtypi me rastin e fillimit të Fushatës së Ndihmës së Parë. Kryqi i Kuq i RMV zbatoi fushatën duke vënë theksin në shoferët me patentë tanimë ekzistuese

Të organizuar 1.093 kurse të ndihmës së parë për shoferë

Të përfshirë 14.910 kandidatë

Të organizuara 6 kurse të ndihmës së parë për persona juridikë

Të përfshirë 633 persona juridikë të organizatave të ndryshme të punës

Të aftësuar 13 ligjërues dhe 11 demonstrues të ndihmës së parë.

shoferi dhe certifikatë të ndihmës së parë. U mbajtën 158 kurse falas të rifreskimit për 3383 shoferë të cilët patën mundësinë për të rifreskuar njohuritë e tyre të ndihmës së parë. Kurset u zbatuan nga korriku deri në shtator në territorin e gjithë vendit. U përgatit një video-sport dhe materiale promovimi. U realizuan 74 ligjërata informative dhe u edukuan 2674 të rinj të moshës 16-17 vjeç. KKQ i Shkupit zhvilloi një trajnim për personat e pastrehë në Pikën e Të Pastrehëve më 20.12.2019 dhe një trajnim për fëmijët e Qendrës Fëmijët në rrugë "Shuto Orizare" që u zhvillua në Shtëpinë e Bjeshkatarëve – Vodno për gjithsej 40 fëmijë të moshës 5 - 13 vjeç.

Gara XXVIII Shtetërore e Ekipave të Ndihmës së Parë.

Organizuar nga Kryqi i Kuq i RMV më 21 dhe 22 shtator të vitit 2019 në Manastir u mbajt Gara XXVIII Shtetërore e Ekipave të Ndihmës së Parë, me moton “Ndihma e Parë dhe Personat e Margjinalizuar”. Në këtë garë morën pjesë 28 ekipe të Organizatave Komunale të Kryqit të Kuq. Vendin e parë në garë e zuri ekipi i ndihmës së parë i OKKK Çair, vendin e dytë e zuri ekipi i ndihmës së parë i OKKK Manastir dhe vendi i tretë i takoi ekipit të OKKK Koçanë. Makijazhistët e prezantimit real të plagëve dhe lëndimeve realizuan një ushtrim demonstrues.

Shënim i Ditës Botërore të Ndihmës së Parë. Dita Botërore

e Ndihmës së Parë u shënuar me moton "Parandalimi i përjashtimit përmes ndihmës së parë", me qëllim të ngritjes të vetëdijesimit publik për nevojën e marrjes së masave për trajtimin e lëndimeve të personave me artësi të kufizuar. Me moton "Padituria jote kushton jetë" më 13 shtator u shënuar Dita Botërore e Ndihmës së Parë në Shkup. Ekipet Mobile të Kryqit të Kuq në fshatin Llojan në bashkëpunim me popullsinë lokale organizuan një stërvitje demonstruese të ndihmës së parë. Më 14.09.2019, Kryqi i Kuq Ohër prezantoi njohuri dhe teknika të ndihmës së parë për lëndime të ndryshme. Të njëjtën ditë u organizua një stërvitje demonstruese e simulimit – aksident trafiku nga OKKK Radovish. OKKK Kumanovë më 08.09.2019 mori pjesë në ngjarjen "Së bashku për qytetarët" që u organizua në kuadër të shënimit të Ditës së Pavarësisë. Në OKKK Strugë, Koçanë, Krushevë u zhvilluan ligjëratë edukative dhe ushtrime të ndihmës së parë. OKKK Veles me 8 vullnetarë kreu një trajnim të edukimit të bashkëmoshatarëve të ndihmës së parë. OKKK Gostivar organizoi një ushtrim demonstrues të ndihmës së parë – shpëtimi dhe ofrimi i ndihmës së parë në Stadiumin e Ovtetit.

DHURIMI I GJAKUT

Aksionet e dhurimit të gjakut. Kryqi i Kuq i RMV dhe Instituti i Mjekësisë së Transfuzionit në vitin 2019 realizuan 55.432 njësi gjak ose detyrimet e planikuara i përbushëm për 100.78%. Në Qytetin e Shkupit, Organizatat Komunale të Kryqit të Kuq Gazi Babë, Karposh, Kisella Vodë, Qendër dhe Çair në vitin 2019 realizuan 20.175 njësi gjak. Në organizatat komunale të Kryqit të Kuq nga brendia e vendit, në vitin 2019 u realizuan 35.257 njësi gjak. Në Spitalin e Përgjithshëm të Qytetit "8 Shtatori" në Shkup, në Shërbimin e Mjekësisë së Transfuzionit në vitin 2019 u realizuan 2.245 njësi gjak. Në Qendrën Ditore të Dhurimit të Gjakut në SHOH "Dare Xhambaz" në Shkup në vitin 2019 u realizuan 2.440 njësi gjak. Ekipi i Koordinimit koordinoi 776 aksione të dhurimit të gjakut.

U shënuar 17 Marsi – Dita e Dhurimit të Gjakut në RMV. Më 15 mars të vitit 2019 në Veles u mbajt një ngjarje solemne me rastin e 17 Marsit. Fitues të pllakave për planin e përbushur të dhurimit të gjakut në vitin 2018 janë Organizatat Komunale të Kryqit të Kuq Manastir, Karposh, Dellçevë, Çair, Vallandovë, Krushevë, Negotinë, Kriva Pallankë, Strugë, Kavadar, Probištip, Gazi Babë, Shtip, Sveti Nikole. Rezultate më të mira realizuan Organizatat Komunale të Kryqit të Kuq Veles, Vinicë dhe Qendër. Me rastin e 17 Marsit – Ditës së Dhurimit të Gjakut në RMV në shumë OKKK dhe KKQSH u organizuan ngjarje solemne ku u dhanë mirënjojhe jubilare për organizata dhe dhurues të shumëfishtë të gjakut.

U shënuan Ditët e NATO-s. Kryqi i Kuq i RMV dhe Instituti i Mjekësisë së Transfuzionit në bashkëpunim me Seksionin e Bashkëpunit Civil-Ushtarak të Shtabit të Përgjithshëm të ARMV dhe Ministrinë e Mbrojtjes, organizoi dy aksione të dhurimit të gjakut më 5 dhe 8 prill në Prilep dhe Shkup me pjesëtarë të ARMV me rastin e shënimit të Ditëve të NATO-s me moton "NE JEMI NATO". Gjak dhuruan gjithsej 47 pjesëtarë të ARMV.

Janë mbajtur forma edukative për dhurimin vullnetar të gjakut. Nga 03-04 maj të vitit 2019 në Strugë u zhvillua punëtoria e edukimit të motivuesve për dhurimin vullnetar të gjakut me 25 pjesëmarrës. Në këtë punëtori u diskutuan format e motivimit për dhurimin e gjakut. Kryqi i Kuq i RMV organizoi një seminar për dhurimin e gjakut në temën "Ushqimi sipas grupeve të gjakut dhe mënyra e shëndetshme e jetës" në periudhën nga 27-30 qershor të vitit 2019 në Strugë ku morën pjesë 32 veta. Nga 13-15 shtator të vitit 2019 në Strugë u zhvillua punëtoria për dhurimin vullnetar të gjakut. Në këtë punëtori morën pjesë 35 veta - motivues

të rindj të Klubit 25 të KKQ të Shkupit dhe OKKK Manastir, të rindj të Klubit 25 të Kryqit të Kuq të Shqipërisë dhe Klubit 25 të Organizatës së Qytetit të KK Novi Sad nga Serbia dhe 10 anëtarët të Klubit të Dhuruesve të Gjakut të Kryqit të Kuq të Qytetit të Shkupit.

Forumi për dhurimin vullnetar të gjakut.

Me rastin e 14 Qershorit – Ditës Botërore të Dhurimit të Gjakut, Kryqi i Kuq dhe Ministria e Shëndetësisë organizuan një Forum për dhurimin vullnetar të gjakut që u zhvillua më 21 dhe 22 qershor të vitit 2019 në Strumicë me temën "Gjak i sigurt për të gjithë". Në këtë forum morën pjesë 34 përfaqësues të Ministrisë së Shëndetësisë, Kryqit të Kuq, Institutit të Mjekësisë së Transfuzionit, Fondit të Sigurimit Shëndetësor, Shtatmadhorisë së ARMV, sekretarë të organizatave komunale të Kryqit të Kuq, Klubi i Dhuruesve të Gjakut, dhe përfaqësues kompanishë.

U-përbushën detyrimet e planit të OKKK për dhurimin e gjakut në vitin 2019
Manastiri 101.12%, Vallandova 106.14%,
Velesi 240.68%, Vinica 202.97%, Dellçeva
102.60%, Kavadari 178.50%, Kriva Pallanka
113.50%, Krusheva 102.86%, Negotina
105.05%, Probištipi 186.41%, Sveti Nikoleja
190.10%, Struga 127.22%, Shtipi 145.78%,
Gazi Baba 147.55%, Karposhi 113.40%,
Qendra 230.80%, Çairi 108.82%.

Plani Integral Vjetor për organizimin e aksioneve të dhurimit të gjakut në RMV në vitin 2019. Më 25 dhe 26 nëntor të vitit 2019 në Gostivar dhe Koçanë u mbajtën Takime rajonale të dhurimit të gjakut. Në këto takime morën pjesë përfaqësues të disa organizatave komunale të Kryqit të Kuq. U rishikuan propozim-planet operative për organizimin e aksioneve të dhurimit të gjakut në vitin 2020 dhe u dhanë rekandime për një koordinim, bashkëpunim dhe realizim më të mirë. Në bazë të diskutimeve dhe rekandimeve të OKKK dhe shërbimeve të mjekësisë së transfuzionit u përgatit Plani Integral Vjetor për organizimin e aksioneve të dhurimit të gjakut në RMV për vitin 2020.



TRANSPARENTË DHE LLOGARIDHËNËS PARA PUBLIKUT

Informimi dhe marrëdhëniet me publikun ishin pjesë integrale e përpjekjeve të përgjithshme të Organizatës drejt përmirësimit të transparencës dhe llogaridhënieve dhe përmirësimit të imazhit të Shoqatës Nacionale. Kredibilitetin e tij, Kryqi i Kuq i RMV e ka ndërtuar duke realizuar një komunikim pozitiv me çdo partner/përdorues të shërbimeve të tij.



Rrjetet sociale të Kryqit të Kuq të RMV. Ridizajnim i dhe përmirësimi i faqes së internetit të RMV lejoj një hapësirë për shpalljen e një numri të madh informacionesh të larmishme me një strukturë që synon kategoritë ndryshme vizitorësh. Pasurimi i tillë i ueb-faqes me përbajtje ndërvepruese kontribuoi në vizitueshmërinë më të madhe të qytetarëve të RMV dhe më gjérë. Informacioni i faqes së internetit dhe rrjeteve sociale të KKRMV është në tri gjuhë.

Rrjetet sociale të Kryqit të Kuq të RMV

23 Stikerë Red Cross të Viberit

•Ueb-faqja
www.redcross.org.mk

<https://www.instagram.com/macedonianredcross/>

<https://www.facebook.com/Crven-KrstNaRepublika-SevernaMakedonija>

Stikerët e Viberit Kryqi i Kuq krijoj stikerë Viberi për aktivitetet e Shoqatës Nacionale. 23 stikerët shprehin situata të ndryshme zbatimëse dhe emocionale që mund të përdoren në komunikimin e përditshëm të përdoruesve. Në këtë mënyrë, Organizata jonë u bë e afërt dhe aktive gjithashtu në sferën virale. Duke krijuar stikerët e tij të Viberit, KKRMV u bë një nga organizatat e para joqeveritare që kanë stikerë relevantë gjuhësorë - lokalë si një mënyrë interesante, dinamike dhe kreative e komunikimit.

E-gazeta Info. Botimet javore të gazetës elektronike të Kryqit të Kuq janë një mjet i suksesshëm i informimit të vullnetarëve, partnerëve, bashkëpunëtorëve tanë rreth aktiviteteve që i realizojmë në nivelin lokal, nacional dhe ndërkombëtar. Në vitin 2019 u përgatiten 100 numra të E-gazetës Info me gjithsej 885 tekste të botuara. Gazeta u distribuua në 82.716 adresa e-maili dhe ajo rregullisht është azhurnuar dhe botuar në faqen e internetit të KKRMV.



Publikimet. Javët tradicionale të përcaktuara në Ligjin e Kryqit të Kuq, si dhe një numër i madh aktivitetesh të projektit dhe dokumentesh strategjike në kuadër të veprimtarisë botuese të Shoqatës Nacionale edhe këtë vit rregullisht u plotësuan me broshura, flaerë, posterë, doracakë, marka me pagesë shtesë dhe lloje të tjera botimesh. Duke bartur në vete porositë humanitare, u arritën rezultate të dukshme tek grupet e synuara dhe në të njëjtën kohë kjo gjithashtu pozitivisht ndikoi në rritjen e imazhit të Shoqatës Nacionale. Të gjitha botimet janë përgatitur në gjuhën maqedonase dhe në atë shqipe, dhe një pjesë e tyre gjithashtu në gjuhën angleze.

Bashkëpunimi me mediumet. Më tepër se 50 njoftime për shtyp, konferanca dhe paraqitje publike në mediumet elektronike, mjetet e informimit publik ishin pjesë e aktivitetave të Kryqit të Kuq të RMV. Mbulimi mediatik nxit paanshmërinë dhe prezantimin objektiv të aktivitetave dhe projekteve, dhe ndërtimin e të a.q. "koalicion" me gazetarët për të nxitur opinionin publik në drejtim të arritjes së transparencës më të madhe në veprimtarinë e Kryqit të Kuq.

Punëtoria e komunikimit në situata krize. Kryqi i Kuq, më 24 shtator të vitit 2019, i mbështetur nga KNKK organizoi një punëtori me punonjësit dhe vullnetarët e Kryqit të Kuq me qëllim të avancimit të bashkëpunimit të ndërsjellë dhe shkëmbimit të informacionit për informimin dhe komunikimin në situata të krisës. Kryqi i Kuq prezantoi përvojat e mekanizmit/pozicionimit të strukturave në KKRMV për përballimin e situatave të jashtëzakonshme/krizave nga perspektiva e komunikimeve.

Aplikimi i standardeve të brendimit të Kryqit të Kuq. Kryqi i Kuq i RMV zhvilloi një punëtori më 09.04.2019 në OKKK Manastir ku morën pjesë OKKK Manastir, Resnjë, Ohër, Prilep, Kavadar, Demir Hisar, Negotinë, për aplikimin e standardeve të brendimit të Kryqit të Kuq për të kontribuuar në unitet, dizajn të unifikuar, dukshmëri dhe njohje.

Pjesëmarrja në Festivalin e Filmit në Varnë 13-21.06.2019. Në periudhën 13-21.06.2019 në Varnë, Bullgari, u mbajt Festivali i 18-të me radhë Ndërkombëtar i Filmave të Kryqit të Kuq dhe Shëndëtësisë. Në këtë festival u prezantuan filma nga e gjithë bota, dhe të pranishme ishin delegacione nga shumë shoqata nacionale. Si pjesë e programit të filmit u emitura gjithashtu filmi "I pastrehu" i përgatitur nga Kryqi i Kuq, i cili prezantoi programin e mbështetjes së të pastrehëve në RMV.

E-GAZETA INFO

100 numra të botuar

885 tekste

Të shpërndara në
82.716 adresa
e-maili



DISEMINIMI

Aktivitetet e diseminimit u orientuan drejt përhapjes së njojurive për Lëvizjen Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe, duke avancuar sistemin e kryerjes së diseminimit të përgjithshëm, diseminimin e DNH-së dhe diseminimin e DNH-së për grupe të synuara të veçanta.

Sesionet e diseminimit me Armatën e RMV dhe Policinë Kufitare. Në përputhje me marrëveshjen e nënshkruar të bashkëpunimit të Kryqit të Kuq të RMV me Ministrinë e Mbrojtjes së RMV dhe Armatën e RMV, Kryqi i Kuq i RMV në vitin 2019 zhvilloi 10 punëtori diseminimi për 300 oficerët e ARMV dhe nëpunësit policorë duke vënë theksin në promovimin e punës së Lëvizjes së Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe, Shoqatës Nacionale, respektimin e DNH-së dhe rolin dhe mundësitet e bashkëpunimit midis Kryqit të Kuq dhe ARMV në kohë paqeje (qetësie) ose situata të jashtëzakonshme. Një formë e këtillë e bashkëpunimit gjithashtu u zhvillua edhe me përfaqësues të MPB-së për të paraqitur më mirë rolin ndihmës të Kryqit të Kuq në shtet.

Takim pune në Armatën e RMV HMë 24.06.2019 një delegacion i Kryqit të Kuq të RMV, i udhëhequr nga Sekretari i Përgjithshëm, Dr. Sait Saiti, kishte takim me Gjeneralmajorin Vasko Gjurçinovski, Shef i Shtabit të Përgjithshëm të Armatës së RMV. U diskutua bashkëpunimi i ndërsjellë, veçanërisht promovimi i të drejtës ndërkombëtare humanitare dhe aktivitetet të cilat i implementon Kryqi i Kuq në këtë sferë përmes Klubit të Diseminuesve për promovimin e DNH-së në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Klubi i Diseminuesve të DNH-së në Kryqin e Kuq – Më 19.02.2019, Kryqi i Kuq formoi një Klub Diseminuesish të Së Drejtës Ndërkombëtare Humanitare (DNH). Klubi përbëhet nga profesorë të ftuar dhe kompetentë dhe ekspertë të DNH-së. Qëllimi eshtë të sigurohet një qasje gjithëpërfshirëse për diseminimin, promovimin dhe implementimin e rregullave dhe parimeve humane të DNH-së, gjegjësisht Ligji i Gjenevës dhe Ligji i Hagës dhe konventa të tjera ndërkombëtare të lidhura

me mjetet, mënyrën dhe kategoritë e viktimave në rast të konflikteve të armatosura ndërkombëtare dhe jo ndërkombëtare dhe katastrofave.

Punëtoria e Klubit të Diseminuesve të Së Drejtës Ndërkombëtare Humanitare (DNH)

– Në periudhën nga 7 deri 9 Qershor të vitit 2019 në Strugë u mbajt një takim pune i Klubit të Diseminuesve të Së Drejtës Ndërkombëtare Humanitare. U diskutua gjendja momentale dhe aktivitetet e Shoqatës Nacionale në sferën e Së Drejtës Ndërkombëtare Humanitare dhe aktivitetet që duhet të ndërmerr Kryqi i Kuq i RMV, i mbështetur nga Klubi i Diseminuesve të DNH për promovimin e DNH për grupe të ndryshme të synuara në vend, veçanërisht për rininë studentore, ARMV dhe MPB, dhe të gjitha institucionet përgjegjëse që kanë një rol të caktuar në promovimin dhe diseminimin e DNH në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

10 punëtori diseminimi për 300 oficerë e ARMV dhe nëpunësit policorë

Punëtoria e studentëve “Hyrje në Të Drejtën Ndërkombëtare Humanitare” –

Kryqi i Kuq i RMV në kuadër të aktiviteteve të planifikuara të Klubit të Diseminuesve të Së Drejtës Ndërkombëtare Humanitare, organizoi një punëtori me titullin “Hyrje në Të Drejtën Ndërkombëtare Humanitare”, që u zhvillua në Hotelin “Solferino”, Strugë, nga 15-17 nëntor të vitit 2019. Qëllimi i



punëtorisë ishte njohja me parimet dhe standartet humanitare, me rregullat e luftës, aplikimi dhe implementimi i tyre praktik, pasojat e mosrespektimit ose shkeljes së rregullave të DNH, si dhe roli i Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (KNKK) në diseminimin e rregullave të DNH. Më 18 dhjetor, Kryqi i Kuq i RMV dha falënderime për studentët që morën pjesë në këtë punëtori.

Promovimi i Doracakut të Së Drejtës Ndërkombëtare Humanitare për parlamentarët

Kryqi i Kuq më 01.11.2019 në Kuvendin e RMV promovoi Doracakun e Së Drejtës Ndërkombëtare Humanitare (DNH) për parlamentarët. Doracaku i dedikohet deputetëve në zbatimin e DNH, çështjeve kyç në rast të konflikteve të armatosura, duke filluar nga aktet e terrorizmit e deri te dhuna seksuale, përdorimit të teknologjive të reja, mbrojtjes së të dhënavë personale të viktimave të konflikteve të armatosura, instrumenteve model dhe materialeve të referimit për respektimin e marrëveshjeve në përputhje me DNH dhe zbatimit dhe aplikimit të drejtë të këtyre marrëveshjeve në vend dhe aktiviteteve të Unionit Ndër-parlamentar dhe Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq.

Komiteti Nacional i Së Drejtës Ndërkombëtare

Humanitare Komiteti Nacional i Së Drejtës Ndërkombëtare Humanitare (DNH) me seli në Kryqin e Kuq që kryesohet nga përfaqësuesi i Ministrisë së Shëndetësisë për periudhën e viteve 2019-2021, mbajti 2 takime të punës. Trupi emëroi anëtarë të rinj nga ministritë përkatëse dhe inicio procedurën për miratimin e një programi të ri të punës së Trupit për periudhën e viteve 2019–2020.

8 Maji, Dita Botërore e Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe

Ditën Botërore të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe, 8 Majin, Kryqi i Kuq e shënoi në Raguza 360 para mysafrirëve të shumtë, donatorëve, mbështetësve dhe bashkëpunëtorëve, vullnetarëve dhe punonjësve. Në këtë ngjarje morën pjesë shumë organizata komunale të Kryqit të Kuq dhe përdorues të qendrave ditore ku bëhet implementimi i një projekti për mbështetjen dhe socializimin e personave me aftësi të kufizuara mbështetur nga Banka Komerciale. Në këtë ngjarje, paraqitje skenike patën vullnetarët e Klubit Rinor të Kryqit të Kuq të Qytetit të Shkupit, Studioja e Baletit "Eureka" që interperetoj një koreo-dramë me moton # Dashuri, kushtuar Kryqit të Kuq. Përmes qasjes përfshirëse, në paraqitjen skenike morën pjesë gjithashu përfituesit e Qendrës Ditore të Paralizës Cerebrale.

PROMOVIMI I VLERAVE HUMANE

"Kryqi i Kuq në Aksion – Promovimi i Vlerave Humane (KKA-PVH) është një vegël nationale e rekrutimit dhe e mbajtjes së vullnetarëve të rinj të moshës nga 13 deri 17 vjeç. Gjithsej 1091 të rinj, vullnetarë të mundshëm përfunduan trajnimin e diseminimit dhe trajnimin e përpunimit të projekteve të vogla. Ata punuan 150 projekte të vogla për të mirën e komunitetit duke ndihmuar në këtë mënyrë 3.807 persona në gjithë vendin. Në periudhën nga shkurti deri në prill të vitit 2019, janë investuar 34.027 orë vullnetare dhe janë mbledhur 32.659 euro të cilat janë investuar në komunitet. Janë mbajtur 108 trajnime në janar dhe shkurt, dhe pastaj në periudhë prej 2 muajsh, nën mentorin-

min e 36 diseminuesve janë realizuar projektet. Është zhvilluar një punëtori finale në Strugë me 84 pjesë-marrësit që kanë bërë projektet më të mira, dhe me personat që kanë realizuar më së shumti orë vullnetare gjatë implementimit të projekteve së bashku me diseminuesit. Java e Promovimit të Vlerave Humane u shënua nga 21 deri 27 Shtator me moton "Defilo - mos u shtir". Janë dhënë 1036 falënderime për secilin të ri që ka bërë një projekt. OKKK Ohër është fitues i Trofeut PVH – për bërjen e numrit më të madh të projekteve të vogla.



1091 të rinj të përfshirë në Trajnimin KKA-PVH

**150 projekte të vogla
té bëra -
34.027 orë vullnetare
për komunitetin**

**Janë mbledhur
32.659 euro**

SHËRBIMI I KËRKIMIT - RIVENDOSJA E LIDHJEVE FAMILJARE

Shërbimi i Kërkimit të Kryqit të Kuq të RMV gjatë vitit 2019, në Qendrat Pritëse të Migruesve në Gjevgjeli dhe Tabanoc nga Ekipet e Rivendosjes së Lidhjeve Familjare, ofroi shërbime për 77 persona (kontakt me telefon ose përdorim të shërbimeve të internetit). Në vitin 2019 janë trajtuar 9 raste të familjeve të luftëtarëve të huaj duke shkëmbuar porosi familjare me të afërmit e tyre që janë në burgjet në Siri

Shërbime RFL për 77 veta

9 raste RFL për persona të robëruar në Siri

Takimi i Shërbimeve të Kërkimit. Shërbimi i Kërkimit i Kryqit të Kuq të RMV tanimë një vit po punon me raste që njihen si *Luftëtarë të huaj dhe familjet e tyre*. Bëhet fjalë për persona, shtetas të Maqedonisë të cilët gjatë luftës në Siri janë përfshirë si luftëtarë në formacionet paraushtarake në Siri dhe kontakti me familjet e tyre është ndërprerë. Në periudhën 28 Shkurt - 01 Mars, shoqatat nacionale evropiane shkëmbyen përvuja në fushën e sfidave të vendosjes së dialogut me autoritetet, përvodusjen e kontakteve me familjet e personave që gjenden në llogore dhe burgje në Siri.

Konferanca Vjetore e Rivendosjes së Lidhjeve Familjare Në periudhën 14 – 16 Maj të vitit 2019, në Katanja, Itali, u mbajt Konferanca e Rivendosjes së Lidhjeve Familjare. Në këtë konferencë morën pjesë më shumë se 150 persona përgjegjës përvodusjen e lidhjeve familjare/shërbimet e kërkimit të shoqatave nacionale të Rajonit të Evropës. Në Konferencën treditore u diskutuan Strategjia e Rivendosjes së Lidhjeve Familjare 2018+, ndërtimi i një qasjeje integrale të gatishmërisë rajonale në rast katastrofash lidhur me rivendosjen e lidhjeve familjare dhe çështjet e luftëtarëve të huaj dhe familjet e tyre, baza e të dhënave FLEXTRANET, FLA, SFE, shërbimet onlajn të Shërbimit të Kërkimit, icrcfamilylinks.org, TTF, algoritmet RFL etj.

Trajnimi përvodusjen e lidhjeve familjare dhe diseminimin Në periudhën nga 16 deri 18 Qershor të vitit 2019, Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq në bashkëpunim me Kryqin e Kuq të Serbisë realizoi një trajnim përvodusjen e lidhjeve familjare dhe diseminimin, në 3 qendra pritëse të migruesve, në Shid, Serbi. Në këtë trajnim u rishikuan veglat e rivendosjes së lidhjeve familjare dhe platforma Flextranet, dhe aplikacionet TTF, SFE dhe BO.

Takimi Rajonal me temën Shërbimi i Kërkimit Rivendosja e lidhjeve familjare dhe mbrojtja e të dhënavë – Në periudhën nga 05 deri 06 Nëntor të vitit 2019 në Beograd u mbajt Takimi Rajonal përvodusjen e lidhjeve familjare dhe mbrojtjen e të dhënavë. Në këtë takim morën pjesë përfaqësues të shoqatave nacionale të Rajonit. U rishikua Strategjia e re përvodusjen e lidhjeve familjare e viteve 2020-2025 dhe u diskutua mbrojtja e të dhënavë si një nevojë me rastin e rivendosjes së lidhjeve familjare.

MENAXHIMI I RESURSEVE NJERËZORE

DHE MONITORIMI DHE EVALVIMI

Krijimi i një sistemi të monitorimit dhe evalvimit dhe resurseve njerëzore. Në përputhje me rekomandimet e marra nga analiza dhe takimet e strukturës udhëheqëse dhe drejtuese të Organizatës, është vërejtur nevoja e krijimit të një sistemi gjithëpërfshirës të monitorimit dhe evalvimit, përmirësimit të sistemit të shpërblimit të resurseve njerëzore, forcimit të strukturës organizative dhe rishikimit të sistematizimit të punës së Organizatës.

Aktivitetet e realizuara:

- Rishikimi i strukturës organizative dhe sistematizimi i vendeve të punës.
- Hapja e pozitave të reja të punës.
- Krijimi i një sistemi të menaxhimit të performancës dhe monitorimit dhe evalvimit të punonjësve.
- Sigurimi i mbështetjes dhe mentorimi i sapo të punësuarve.
- Zbatimi i vlerësimit të kënaqësisë së punës së punonjësve.

Rezultatet e arritura me sistemin e krijuar për performancën e punonjësve:

- Realizimi i planit të aktiviteteve të punonjësve prej 54% në periudhën nga janari deri në qershor, krahas përbushjes së aktiv-

iteteve prej 72% në periudhën nga Qershor deri në Dhjetor.

- Realizimi i pesë trajnimeve të udhëheqësve për përdorimin e veglave të menaxhimit të performancës.

Vlerësimi i nevojave të zhvillimit organizativ të OKKK dhe KKQSH

- Janë zbatuar 10 vizita në terren dhe janë vlerësuar 33 OKKK dhe KKQSH dhe janë siguruar rekomandime për punën e mëtejshme

Përmirësimi i softuerëve të punës me resurset njerëzore dhe monitorimi dhe evalvimi i Kryqit të Kuq të RMV

- Janë organizuar trajnime për përdorimin e veglave të reja të monitorimit dhe evalvimit dhe janë trajnuar 17 punonjës
- Janë mbajtur takime me 33 sekretarë të OKKK dhe KKQSH për prezantimin e veglave të reja të monitorimit dhe evalvimit

Avancimi i sistemit të menaxhimit të resurseve njerëzore

- Janë krijuar dhe prezantuar vegla dhe formate të reja të planifikimit dhe njoftimit (anketimi i kënaqësisë së punës, vlerësimi i performancës së punonjësve, takime pune për përmirësimin e bashkëpunimit të ndërsjellë dhe punës në ekip)

RAPORTI FINANCIAR

PËR VITIN 2019

Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë së Veriut punën e tij e prezanton përmes raportit finansiar i cili përban të ardhurat dhe shpenzimet e planifikuara dhe të realizuara. Raporti finansiar është një konfirmim i implementimit të suksesshëm të aktiviteteve të programit dhe projektit të mbështetura nga partnerë vendorë dhe të huaj të Organizatës.

Puna e Organizatës e prezantuar përmes të dhënave financiare tregon një vit të përfunduar me sukses me realizim buxheti prej 206,33% pér dallim nga viti 2018 kur realizimi ishte 130,74%, si rezultat i implementimit të Ndryshimeve në Ligjin e KK, në përputhje me të cilin fondet e kompensimit të regjistrimit të automjeteve në territorin e RMV grumbullohen në Zyrën Qendrore të KKR MV dhe më tej shpërndahen në organizatat komunale të KK dhe Kryqin e Kuq të Qytetit të Shkupit. Të ardhurat vetjake janë realizuar me 181,20% dhe marrin pjesë me 29,08% nga të ardhurat e përgjithshme që janë realizuar. Të ardhurat nga organet dhe donatorët janë të ardhura të dedikuara, pjesa më e madhe e të cilave direkt transferohet në organizatat komunale, ku përdoren pér implementimin e aktiviteteve të projektit. Këto të ardhura janë realizuar me 218,78% dhe shënojnë rritje në krahasim me vitin 2018 kur janë realizuar 134,36%. Ato mbulojnë 70,92% të të ardhurave të realizuara përgjithësish në vitin 2019.

Në pjesën e shpenzimeve mund të vërtetohet se shpenzimi është i kontrolluar dhe me qëllim, që është qëllim kryesor i çdo organizate Nga realizimi i të ardhurave të përgjithshme, shpenzimet funksionale respektivisht programore janë rritur në shumën nominale në krahasim me vitin paraprak dhe janë 73,20%, shpenzimet e pagave të punonjësve janë 11.62%, dhe shpenzimet materiale 15,18%. Nga shpenzimet e realizuara

përgjithësisht, 26,28% i referohen nevojave të Zyrës Qendrore dhe shënojnë rritje në krahasim me vitin e kaluar, 58,58% direkt janë transferuar në organizatat komunale të Kryqit të Kuq dhe Kryqit të Kuq të Qytetit të Shkupit dhe shënojnë rritje si rezultat i implementimit të Ndryshimeve të Ligjit të KK, ndërsa 15,14% shpenzime të tjera janë mjete që janë shpenzuar në Zyrën Qendrore dhe i referohen realizimit të aktiviteteve programore të organizatave komunale të KK dhe KK të Qytetit të Shkupit.

Një pjesë e tepricës së mjeteve financiare respektivisht dallimi pozitiv midis të ardhurave dhe shpenzimeve janë mjete të dedikuara që i referohen projekteve që vazhdojnë të realizohen në vitin 2020.

Këshilli udhëheqës i Kryqit të Kuq të RMV formoi një komision i cili bëri kontrollin e brendshëm të punës financiare dhe materiale. Gjithashtu u angazhua një shtëpi e pavarur e revizionit, e cila kreu revizionin në përputhje me Ligjin e Revizionit dhe Standardet Ndërkontëtare të Raportimit Financiar dhe Dispozitave të Kontabilitetit që vleinë në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Sipas mendimit të Shtëpisë së Revizionit, gjendja financiare e Organizatës së Kryqit të Kuq të RMV është paraqitur në mënyrë reale dhe objektive.

Raporti finansiar i referohet vetëm punës së Zyrës Qendrore të Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë së Veriut.



RAPORTI FINANCIAR PËR VITIN 2019

	Buxheti 2019	Realizuar në 2019	%	në 2018			
TË ARDHURAT E PËRGJITHSHME Burimet vetjake të të ardhurave Të ardhurat nga organet/donatorët	60,052,708.00 19,887,628.00 40,165,080.00	123,908,808.00 36,035,907.00 87,872,901.00	206.33 181.20 218.78	130.74 117.12 134.36			
SHPENZIMET E PËRGJITHSHME Rrogat dhe kompensimet për punonjësit Shpenzimet për materialet dhe shërbimet Shpenzimet funksionale (programore)	60,052,708.00 12,142,964.00 8,019,712.00 39,890,032.00	93,292,949.00 10,836,164.00 14,165,990.00 68,290,795.00	155.35 89.24 176.64 171.20	0.00 92.15 156.30 106.08			
DALLIMI	0.00	30,615,859.00					
TË ARDHURAT							
PËRSHKIMI	Burimet vetjake të të ardhurave	Të ardhurat nga organet/ donatorët	Buxheti 2019	Realizuar nga burimet e veta	Realizuar nga organet dhe donatore	Realizuar në 2019	%
74 TRANSFERET DHE DONACIONET							
741 Ministria e Punës dhe Politikës Sociale	6,000,000.00	6,000,000.00	7,958,211.00		7,958,211.00	132.64	
741 Dhurimi i gjakut (Ministria e Shëndetësisë)		6,600,000.00	6,600,000.00		7,995,999.00	7,995,999.00	121.15
742 Programet sociale-humanitare	450,000.00	2,700,000.00	3,150,000.00	1,371,511.00	3,958,249.00	5,329,760.00	169.20
742 Organizimi dhe zhvillimi		11,960,000.00	11,960,000.00	194,000.00	310,619.00	504,619.00	100.00
742 Ndihma e parë	3,250,000.00		3,250,000.00	3,595,060.00		3,595,060.00	110.62
742 Programet preventive shëndetësore		3,393,760.00	3,393,760.00		3,540,148.00	3,540,148.00	104.31
742 Zhvillimi dhe puna me të rinjtë	336,000.00	530,000.00	866,000.00	173,600.00		173,600.00	100.00
742 Gatishmëria dhe reagimi në rast katastrofash		863,320.00	863,320.00	29,000.00	13,016,455.00	13,045,455.00	1511.08
742 Diseminimi dhe DNH		197,600.00	197,600.00			0.00	0.00
742 KK në aksion - PVH		300,000.00	300,000.00		486,000.00	486,000.00	162.00
742 Marrëdhëniet me publikun				0.00		0.00	0.00
742 Shërbimi i Kérkimit		920,400.00	920,400.00		1,659,026.00	1,659,026.00	0.00
742 Bashkëpunimi ndërkombëtar			0.00			0.00	0.00
742 Puna e projektit dhe mobilizimi i fondeve			0.00			0.00	
742 Financat (të ardhurat tjera)/kreditë për veturë /ndlajet për punonjësit			0.00			0.00	100.00
72 TË ARDHURAT JO TATIMORE						0.00	
725 Nga OKKK (në bazë të kotizacionit)	1,180,000.00		1,180,000.00	1,607,836.00		1,607,836.00	136.26
725 Donacionet nga personat fizikë	350,000.00		350,000.00	26,441.00		26,441.00	7.55
725 Donacionet nga personat juridikë/Shitja e veturave	500,000.00		500,000.00	15,782.00		15,782.00	3.16
725 Pullat postare me pagesë shtesë (nga Ligji i KK)	300,000.00		300,000.00	61,124.00		61,124.00	20.37
723 Nga dhënia me qira e hapësirës afariste/të ardhura të tjera / të ardhura nga shitja e mijeteve kapitale	1,918,800.00		1,918,800.00	2,511,304.00		2,511,304.00	130.88
725 Nga regjistrimi i automjeteve (Fonde nga Ligji i KK)	1,502,828.00	12,700,000.00	14,202,828.00	6,418,643.00	31,344,599.00	37,763,242.00	100.00
725 Të ardhurat tjera/ të ardhurat nga norma e interesit/PVH	100,000.00		100,000.00	75,980.00	8,730.00	84,710.00	100.00
725 Fondi i solidaritetit			0.00	1,960,000.00	15,690,442.00	17,650,442.00	100.00
725 Fondi i Zhvillimit			0.00	958,088.00		958,088.00	100.00
725 Fondi i Dukshmërisë			0.00	778,447.00		778,447.00	100.00
725 Fondi i reagimit urgent në rast katastrofash			0.00	958,088.00		958,088.00	100.00
725 Të ardhurat e transferuara nga viti i mëparshëm	4,000,000.00		4,000,000.00	7,342,792.00	9,862,634.00	17,205,426.00	100.00
TË ARDHURAT E PËRGJITHSHME	19,887,628.00	40,165,080.00	60,052,708.00	36,035,907.00	87,872,901.00	123,908,808.00	206.33

SHPENZIMET

PËRSHKRIMI	Nga burimet e veta	Nga organet dhe donatorët	Buxheti 2019	Realizuar nga burimet e veta	Realizuar nga organet dhe donatorët	Realizuar në 2019	%
SHPENZIMET RRJEDHËSE							
401 RROGAT DHE KOMPENSIMET BAZË	10,492,716.00	1,620,248.00	12,112,964.00	10,038,283.00	632,718.00	10,671,001.00	
402 KONTRIBUTET NGA RROGAT DHE TATIMI PERSONAL	30,000.00	0.00	30,000.00	56,169.00	108,994.00	165,163.00	
SHPENZIMET E PËRGJITHSHME TË RROGAVE	10,522,716.00	1,620,248.00	12,142,964.00	10,094,452.00	741,712.00	10,836,164.00	89.24
420 SHPENZIMET RRUGORE DHE DITORE	100,000.00	0.00	100,000.00	625,945.00	253,542.00	879,487.00	879.49
421 SHËRBIMET KOMUNALE	930,000.00	0.00	930,000.00	824,533.00	181,011.00	1,005,544.00	108.12
422 NGROHJA	480,000.00	0.00	480,000.00	349,354.00	0.00	349,354.00	72.78
423 KOMUNIKACIONI DHE TRANSPORTI	1,755,000.00	31,200.00	1,786,200.00	2,745,544.00	218,097.00	2,963,641.00	165.92
423 MATERIALET	1,390,000.00	1,669,100.00	3,059,100.00	2,751,716.00	946,263.00	3,697,979.00	120.88
424 MIRËMBAJTJA E VAZHDUESHME	1,066,000.00	175,500.00	1,241,500.00	990,934.00	0.00	990,934.00	79.82
425 SHËRBIMET E KONTRAKTUARA	3,888,012.00	6,834,872.00	10,722,884.00	4,523,042.00	8,532,780.00	13,055,822.00	121.76
426 SHPENZIMET TJERA OPERATIVE	300,000.00	0.00	300,000.00	59,408.00	0.00	59,408.00	19.80
463 TRANSFERET NGA ORGANIZATAT JOFITIMPRURËSE	150,000.00	22,333,360.00	22,483,360.00	0.00	54,652,511.00	54,652,511.00	243.08
SHPENZIMET E PËRGJITHSHME RRJEDHËSE	10,059,012.00	31,044,032.00	41,103,044.00	12,870,476.00	64,784,204.00	77,654,680.00	188.93
SHPENZIMET KAPITALE							
483 BLERJA E MOBILEVE DHE PAJISJEVE TË ZYRËS	0.00	0.00	0.00	1,469,100.00	0.00	1,469,100.00	100.00
483 BLERJA E AUTOMJETEVE	600,000.00	0.00	600,000.00	0.00	0.00	0.00	0.00
481 MIRËMBAJTJA BAZË DHE SPECIALE	1,006,700.00	0.00	1,006,700.00	1,525,923.00	0.00	1,525,923.00	151.58
SHPENZIMET E PËRGJITHSHME KAPITALE	1,606,700.00	0.00	1,606,700.00	2,995,023.00	0.00	2,995,023.00	186.41
NDIHMA, DONACIONE DHE DHËNIE TË TJERA	0.00	5,200,000.00	5,200,000.00	67,570.00	1,739,512.00	1,807,082.00	34.75
SHPENZIMET E PËRGJITHSHME	22,188,428.00	37,864,280.00	60,052,708.00	26,027,521.00	67,265,428.00	93,292,949.00	155.35

Shërbimi i Financave dhe Revizionit


Zhaklina Popoviq

Sekretari i Përgjithshëm




Dr. Sait Saiti

	%
transferet në OKKK	58.58
shpenzimet për zyrën qendrore	26.28
shpenzimet e zyrës qendrore për OKKK-të	15.14
93,292,949.00	100.00

TË REALIZUARA TË ARDHURA NË 2019



SHPENZIME NË 2019



Udhëheqësë së

**KRYQIT TË KUQ TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT
SHKUP**

Ne realizuam revizion në raportet e paraqitura financiare të "KRYQIT TË KUQ TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT" (në tekstin e mëtejshmë Organizata), që kycin edhe Bilancin e gjendjes më 31 dhjetor të vitit 2019, si dhe Bilancin e të hyrave dhe të dalurave dhe Raportin për ndryshime në fondin afarist për vitin i cili mbaron po atë ditë dhe shqyrtimin e politikave të rëndësishme kontabiliste dhe vërejtjeve tjera sqauese.

Raportet financiare të paraqitura për vitin 2019 përbëhen nga raportet për punën e rregullt të Organizatës si dhe raportet për projektet: Federata ndërkombëtare e KK dhe GJHK, Fushata për HIV/SIDA; Kryqi i Kuq i Austrisë - Ndihma e parë psikologjike dhe përkrahje psiko - sociale në situata emergjente; Ndërmarrja e aksionit për inkluzion social për personat e moshuar; Promovimi i vlerave humane, Kryqi i kuq i Gjermanisë, Konkurencë në tregun e punës dhe raportet për katër fonde: (1) Fondi për transparencë, (2) Fondi për përgjigje emergjente gjatë katastrofave, (3) Fondi për zhvillim dhe (4) Fondi për solidaritet; Preventivë nga HIV tek PID Krijim i mundësive për punësimë të reja të gruas, si dhe llogari për Donacione nëpërmjet formës elektronike dhe Mjete nga Ligji për KK. Projektet finançohen nga donatorë të posaçëm dhe të njëjtat realizohen nëpërmjet nënlogarive të posaçme (dedikuese) të Organizatës. Për ata Organizata nuk përgatit raporte të posaçme financiare.

Përgjegjësia e menaxhmentit për raportet financiare

Menaxhmenti i Organizatës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantim objektiv të këtyre raporteve financiare në pajtueshmëri me Ligjin për kontabilitet të organizatave joprofitabile dhe standartet për lajmërim financiar në bazë të gatshme. Kjo përgjegjësi kryc: formën, implementimin dhe mirëmbajtjen e kontrollit të brendshëm që është relevant për përgatitjen dhe prezantimin objektiv të raporteve financiare që janë të liruara nga paraqitura e gabueshme materiale, pa dallim se a janë rezultat i mashtimit apo gabimit, zgjedhje dhe zbatim të politikave adekuate kontabiliste, si dhe bërjen e vlerësimive kontabiliste të cilat janë të kapshme në rrithana.

Përgjegjësia e revizorit

Përgjegjësia jonë është të shprehim mendimin për këto raporte financiare në bazë të revizionit tonë. Revizionin e zbatuam në pajtueshmëri me Standarde ndërkombëtare për revizion. Ato standarde kërkojnë t'i respektojmë kërkesat etike dhe ta planifikojmë e zbatojmë revisionin që të marim besueshmëri të kapshme për atë se raportet financiare a janë të liruara nga paraqitura e gabueshme materiale.

Revizioni kryc zbatimin e procedurave për grumbullimin e dëshmive revizore për shumat dhe zbardhjet në raportet financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i revizorit, kyçur edhe vlerësimin e rreziqeve nga paraqitura e gabueshme materiale në raportet financiare, pa dallim se a janë rezultat i mashtimit dhe gabimit. Kur i bën ato vlerësimë të rezikut, revizori e shqyrton kontrollin e brendshëm relevant për përgatitjen dhe prezantimin objektiv të raporteve financiare që të formojë procedura revizore që janë adekuate me rrithanat, por jo për qëllimin e të shprehurit të mendimit përfektivitetin e kontrollit të brendshëm.

Gjithashtu, revizioni kryc edhe notën adekuate të politikave kontabiliste të shfrytëzuara dhe të vlerësimeve kontabiliste të bëra nga ana e menaxhmentit, si dhe notim të prezantimit të përgjithshëm të raporteve financiare.

Ne besojmë se dëshmitë revizore të cilat i kemi grumbulluar janë të kapshme dhe adekuate që të sigurojnë bazë përmendimin tonë revizor.

Mendimi i revizorit


Sipas mendimit tonë, raportet financiare të paraqitura të "KRYQIT TË KUQ TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT" e paraqesin në mënyrë reale dhe objektive në të gjitha aspektet e rëndësishme, gjendjen financiare të organizatës, është 31 dhjetor të vitit 2019, si dhe rezultatet e punës së vet dhe ndryshimet në fonde për vitet që mbarojnë po atë ditë, në pajtueshmëri me Ligjin për kontabilitet të organizatave jo profitabile dhe standartet për paraqitje financiare në bazë të të hollave të gatshme.

Raport përkërsës tjerë juridike dhe rregullative

Menaxhmenti i Organizatës gjithashtu është përgjegjës për përgatitjen e raportit vjetor për punën në pajtueshmëri me Ligjin për shoqatat dhe fondacionet. Përgjegjësi e jona në pajtueshmëri me Ligjin për revizion është që të lajmërojmë se a është konzistent raporti vjetor me llogarinë vjetore dhe raportet financiare për vitin që mbaron më 31 Dhjetor të vitit 2019. Puna jonë në bazë të raportit vjetor për punë është realizuar në pajtueshmëri me SNR 720 dhe është e kufizuar me raportim se a janë konzistent informacionet historike financiare të paraqitura në raportin vjetor me llogarinë vjetore dhe raportet financiare të reviduara.

Raporti vjetor për punë është konzistent, nga të gjitha aspektet materiale, me llogarinë vjetore dhe raportet financiare të reviduara të "KRYQIT TË KUQ TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT", Shkup për vitin që mbaron më 31 Dhjetor të vitit 2019.

Shkup, 27 Shkurt 2020



Revizor i autorizuar
Zvonko Koçovski

TABLE OF CONTENTS:

INTRODUCTION	71
DEVELOPMENT ACTIVITIES OF THE NATIONAL SOCIETY AND INTERNATIONAL PARTNERSHIP COOPERATION	72
MANAGEMENT OF VOLUNTEERS AND MEMBERS	74
YOUTH ACTIVITIES	75
PROJECT OPERATION	77
MOBILIZATION OF FUNDS FROM THE CORPORATE SECTOR	77
SOCIAL HUMANITARIAN PROGRAMMES	78
DISASTER PREPAREDNESS AND RESPONSE	84
WATER SAFETY	88
MOUNTAIN RESCUE	89
HEALTH PREVENTIVE ACTIVITIES	90
FIRST AID	92
BLOOD DONATION	93
TRANSPARENCY IN THE OPERATION	94
DISSEMINATION	95
PROMOTION OF HUMAN VALUES	97
TRACING SERVICE - RESTORING FAMILY LINKS	97
MANAGEMENT OF HUMAN RESOURCES AND MONITORING AND EVALUATION	98
FINANCE REPORT FOR 2019	99

INTRODUCTION

